

Albanian

**200 Pyetjet Rreth
Biblës dhe Kuranit**

Daniel Wickwire

2015

200 Pyetjet Indeks

| | |
|--|---------|
| Librat e Shenjtë..... | 1-24 |
| Perëndia dhe Allahu..... | 25-50 |
| Fryma e Shenjtë, Engjujt, Demonët & Satani..... | 51-65 |
| Krishti dhe Muhamedi..... | 66-98 |
| Njeriu dhe Mëkati..... | 99-109 |
| Shpëtimi..... | 110-123 |
| Gjërat e Ardhshme..... | 124-132 |
| Çështjet Praktike ne Jetë... | 133-161 |
| Armiqtë dhe Lufta..... | 162-179 |
| Ngjarje Historike..... | 180-200 |

Librat e Shenjtë

1.*

A pranohet se Fjala e Perëndisë është e përjetshme dhe e pandryshueshme? (Lev-i Mahfuz)

Bibla Po / Po Kurani

Isaia 40:8*.....Bari thahet, lulja fishket, por fjala e Perëndisë tonë mbetet përjetë".

Gjoni 1:1-3*.....sepse jeni ringjizur jo nga një farë që priset, por që nuk priset, me anë të fjalës së Perëndisë së gjallë dhe që mbetet përjetë.

1 Pjetri 1:23.....sepse jeni ringjizur jo nga një farë që priset, por që nuk priset, me anë të fjalës së Perëndisë së gjallë dhe që mbetet përjetë.

Yunus 10:64*.....A tyre u jepen myzhde në jetën e dunjasë dhe në jetën tjetër. Nuk ndryshojnë fjalët e All-llahut. E, ai është sukseksi i madh.

Kaf 50:29.....te Unë nuk ndryshon fjala (vendimi)

Shënim: Në historinë Islamik, gjendëshin dy këndveshtrime të kunderta në lidhje me këtë temë, për të cilët Muslimanet kanë luftuar mes tyre. Mu'tazelitet thanë "Jo" këtyre pyetjeve dhe Ash'aritet thanë "Po". Shumica e Myslimanëve sot do të thonë "Po".

2.*

A pranohet se Bibla e Shenjtë është Fjala e Perëndisë? (Tevrati, Zeburi, Inxhili)

Bibla Po / Po Kurani

Romakeve 15:4*.....Sepse të gjitha gjërat që u shkruan në të kaluarën u shkruan për mësimin tonë, që me anë të këmbënguljes dhe të ngushëllimit të Shkrimeve, të kemi shpresë.

1 Korintasve 14:37*.....Në qoftë se dikush mendon se është profet ose frymëror, le të njohë se ato që po ju shkruaj janë urdhërime të Zotit.

Nisa 4:136*.....O ju që besuat, besoni vazhdimisht All-llahun, të dërguarit të Tij, librit që gradualisht ia shpalli të dërguarit të Tij dhe librit që e pat zbritur më parë.

Ankebut 29:46*....."Ne i besuam asaj që na u zbrit dhe që u zbrit juve dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një.."

3.

A zgjodhi Perëndia t'i kumtonte orakujt e shkruajtur të Perëndisë në Bibël përmes ndërmjetësimit të posaçëm të judenjve?

Bibla Po / Po Kurani

Romakeve 3:1-2*.....Cila është, pra, përparësia e Judeut, ose cila është dobia e rrethprerjes? E madhe në çdo mënyrë; para së gjithash sepse orakujt e Perëndisë iu besuan atyre.

Romakeve 9:4*.....të cilët janë Izraelitë dhe atyre u përket birëria, lavdia, besëlidhjet, shpallja e ligjit, shërbimi hyjnor dhe premtimet;

Ankebut 29:27*.....Dhe Ne i dhuruam atij Is-hakun dhe Jakubin, e në pasardhësit e tij shpallëm peygamberllëkun dhe librin e shenjtë (librat e shpallura),

Jathiyah 45:16*.....Ne u patëm dhënë beni israilëve librin dhe peygamberllukun dhe aftësi për të gjykuar në mes të njerëzve, i patëm furnizuar ata me të mira dhe i patëm dalluar nga njerëzit e tjerë.

4.*

A u dha Perëndia profetëve të Biblës aftësinë për të bërë mrekulli të dukshme si dëshmi se ato u dërguan nga Perëndia?

Bibla Po / Po Kurani

Eksodi 10:2*.....dhe me qëllim që ti të mundësh t'u tregosh bijve të tu dhe bijve të bijve të tu gjërat e mëdha që kam bërë, duke vënë në lojë Egjiptasit, dhe shenjat e mia që kam bërë midis tyre, që të dini se unë jam Zoti".

Hebrenjte 2:4*.....ndërsa Perëndia dëshmonte për të me anë shenjash e mrekullish, me vepra të ndryshme të fuqishme dhe me dhurata të Shpirtit të Shenjtë, sipas vullnetit të tij.

Bakara 2:92.....Juve u pat ardhur Musai me argumente

Al-i İmran 3:49*.....të sëmurit në lëkurë, dhe unë me lejen e All-llahut ngjalli të vdekurit: Vertetë, kjo është fakt për ju nëse jeni besimtarë.

Al-i İmran 3:183*.....Thuaju: "Para meje juve u erdhën të dërguar me argumente dhe me atë që e thatë,

5.*

**A "dëshiron" Perëndia t'i mbrojtë të gjithë Librat e Tij të Shenjtë nga ndryshimi dhe prishja.
(Qëllimi / Nijet)**

Bibla Po / Po Kurani

Isaia 14:24 & 26-27*.....27 Me qenë se Zoti i ushtrive e ka vendosur këtë, kush mund t'ia anullojë? Dora e tij është shtrirë dhe kush mund ta detyrojë ta tërheqë?".
Mateu 24:35*.....Qielli dhe toka do të kalojnë, por fjalët e mia nuk do të kalojnë.

Hijr 15:9*.....Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij.
Saffat 37:3 & 7*.....3 Dhe pasha lexuesit, që lexojnë përkujtimin. 7 Dhe me mbrojtje prej çdo djalli të prishur.

Shënim: Krahaso: Psalmet 12:6-7, Psalmet 89:34, Jeremia 36:23-28, & Zbulesa 22:18-19.

6.*

**A mund t'i ruajë Perëndia të gjithë librat e Tij të Shenjtë nga ndryshimi dhe prishja?
(Pushteti / Kudret)**

Bibla Po / Po Kurani

Isaia 46:9-10*.....9 jam Perëndia... 10 "Plani im do të realizohet dhe do të bëj gjithçka më pëlqen",
Marku 12:24*.....Jezusi, duke u përgjigjur, tha atyre: "A nuk është pikërisht për këtë që jeni në gabim, sepse nuk i njihni as shkrimet as pushtetin e Perëndisë?
Luka 21:33*.....Qielli dhe toka do të kalojnë, por fjalët e mia nuk do të kalojnë".
Gjoni 10:35*.....(dhe Shkrimi nuk mund të bjerë poshtë),

En'am 6:115*.....S'ka kush që të ndryshoj fjalët (vendimet) e Tij. Ai është që dëgjon e di.

Yunus 10:64*.....Nuk ndryshojnë fjalët e All-llahut. E, ai është suksesi i madh.

Jinn 72:26-28*.....27 Me përjashtim të ndonjë të dërguari që Ai do. Atëbotë Ai vë roje para edhe prapa tij (kur i shpall fshehtësinë), 28 Për ta ditur (për t'u dukur) se ata kanë kumtuar shpalljet e Zotit të tyre,

7.*

A do t' i lejonte Perëndia Satanin, demonët ose njerëzit të cënonin "qëllimin" dhe "pushtetin" e Tij duke ndryshuar ose prishur tekstin e vërtetë të Librave të Shenjtë që Ai ka dërguar? (Tahrif bi'l-lafz)

Bibla Jo / Jo Kurani

Isaia 55:11*.....Kështu do të jetë fjala ime e dalë nga goja ime; ajo nuk do të më kthehet bosh mua, pa kryer atë që dëshiroj dhe pa realizuar plotësisht atë për të cilën e dërgova.

Luka 16:17*.....Por është më lehtë që të mbarojnë qielli dhe toka, se sa të bjerë poshtë qoftë edhe një pikë nga ligji.

Hajj 22:52*.....Ne nuk dërguam para teje asnjë të dërguar (me shpallje) dhe asnjë pejgamber (të dërguar si vazhdues i shpalljes së mëparshme), e që, kur ai (i dërguari) dëshiroi diç, të mos ia pat hedhur në atë dëshirën e tij djalli, e All-llahu asgjëson atë që hedh djalli, dhe All-llahu fuqizon argumentet e Veta.

Saffat 37:3 & 7.....3 Dhe pasha lexuesit, që lexojnë përkujtimin. 7 Dhe me mbrojtje prej çdo djalli të prishur.

Hakka 69:44-47 & 51*.....44 Sikur të trillonte ai (Muhammedi) për Ne ndonjë fjalë! 45 Ne do ta kapim atë me fuqinë Tonë. 51 Ai është e vërtetë bindëse!

8.

A do të ishte mundur që njeriu të shtrembëronte gojarisht Librat e Shenjtë duke i cituar ato gabimisht ose duke i keqinterpretuar? (Tahrif bi'l-ma'na)

Bibla Po / Po Kurani

Titit 1:11*.....këta ngatërrojnë familje të tëra, duke mësuar ato që s'duhet, për fitim të ndyrë.

Ali-Imran 3:78*.....Në të vërtetë, një grup prej tyre janë ata që pëhtjellojnë gjuhët e tyre kur lexojnë librin (për të deformuar kuptimin) ashtu që ju të mendoni se ajo (shprehje) është nga libri, po ajo nuk është nga (i vërtetë), adje thonë:Kjo është nga All-llahu!"Po ajo nuk është nga All-llahu. Ata duke ditur thonë gënjeshtër për All-llahun.

9.

A blasfemojnë ndaj karakterit të Perëndisë ata që thonë se Bibla është ndryshuar ose prishur meqë nënkuptojnë se Perëndia nuk mundi të bënte asgjë për të parandaluar ndryshimin e Biblës?

(El-Alim, Er-Rahman, Er-Rahim, El-Kadir)

Bibla Po / Po Kurani

Isaia 14:24 & 27*.....14 Zoti i ushtrive është betuar duke thënë: "Në të vërtetë ashtu siç e kam menduar ashtu do të jetë, dhe ashtu si kam vendosur, kështu ka për të ndodhur.

Baqara 2:20, 255*.....20 Vërtetë, All-llahu është i plotëfuqishëm për çdo gjë. 255 All-llahu - s'ka zot pos Tij. I Gjalli, Vigjiluesi. Nuk e ze të koturit, e as gjumi. E Tija është ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë. E nuk lodhet duke i ruajtur (mirëmbajtur), ngase Ai është i Larti, Madhështori.

Shënim: Krahaso: Psalmet 74:10, Psalmet 103:8 & 17-18, Psalmet 94:7-9.

10.

A blasfemojnë ndaj karakterit të Perëndisë ata që thonë se Bibla është ndryshuar ose prishur meqë nënkuptojnë se Satani e ka fituar betejën ndaj të Plotëfuqishmit për Biblën?

(El-Aziz, El-Galib, El-Jebbar, El-Muktedir)

Bibla Po / Po Kurani

Psalmet 94:7-9*.....7 dhe thonë: "Zoti nuk shikon, Perëndia i Jakobit nuk kupton". 9 Ai që ka vënë veshin, a nuk dëgjon? Ai që ka formuar syrin, a nuk shikon?

Yunus 10:21*.....E kur Ne ua dhurojmë njerëzve mëshirën pasi t'i ketë godotur e keqja (skamja), kur qe ata u bëjnë hile argumenteve tona. Thuaj: "All-llahu është më i shpejti në ndëshkim". S'ka dyshim, përcjellësit tanë (melaiket) regjistrojnë atë që po thurrrni ju.

Taha 20:5 & 51-52*5 Mëshiruesi që qëndron mbi Arsh. 51 Ai tha: "Si është gjendja e popjve të mëparshëm?" 52 Dija për ata është te Zoti im, e shënuar në një libër. Zoti im nuk gabon e as nuk harron".

11.

A mund të jetë Perëndia fajtor për standarde të ndryshme e hipokrite, duke mbrojtur vetëm njërin nga Librat e Tij të Shenjtë, por jo gjithë të tjerët?

(El-Adl, El-Hadi, El-Mumim, El-Muksit)

Bibla Jo / Jo Kurani

Psalmet 12:6-7*.....6 Fjalët e Zotit janë fjalë të pastra, si argjend i rafinuar në një furrë prej dheu, i pastruar shtatë herë. 7 Ti, o Zot, do t'i mbrosh dhe do t'i ruash, duke filluar nga ky brez përjetë.

Luka 21:33*.....Qielli dhe toka do të kalojnë, por fjalët e mia nuk do të kalojnë''.

Tevbe 9:111*.....(All-llahu dha) Premtim të cilin e vërtetoi në Tevrat, Inxhill e Kur'an. E kush është më zbatues i sigurt i premtimit të vet se All-llahu?

Hud 11:57.....Vëretet, Zoti im është përcjellës i çdo sendi''.

İbrahim 14:47*.....E kurrsesi mos mendo se All-llahu e shkel premtimin e vet, që u dha të dërguarëve të tij. All-llahu është triumfues që ndërmerr masa ndëshkuese.

Hajj 22:47.....po All-llahu nuk e thyen premtimin e Vet,

12.

A është Fjala e Perëndisë standardi i pandryshueshëm dhe universal me të cilën Perëndia do të gjykojë gjithë njerëzimin në Ditën e Gjykimit? (El-Hakem, El-Hakk, El-Hafiz, El-Hasib)

Bibla Po / Po Kurani

Gjoni 12:48.....Kush më hedh poshtë dhe nuk i pranon fjalët e mia, ka kush e gjykon; fjala që kam shpallur do të jetë ajo që do ta gjykojë në ditën e fundit.

Hijr 15:9-10.....9 Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij. 10 Ne përpara teje kemi dërguar të dërguar në grupet e popujve të hershëm.

Zumar 39:69-70*.....69 libri (shënimet mbi veprat) është vënë pranë dhe sillen pejgamberët e dëshmitarët, e kryhet mes tyre gjykimi me drejtësi, e atyre nuk u bëhet padrejtë. 70 Dhe, secili njeri shpërblehet me atë që ka vepruar,

13.*

A u lejohet besimtarëve të besojnë në një pjesë të Shkrimit e të mos besojnë në një tjetër?

Bibla Jo / Jo Kurani

Veprat 20:27.....sepse nuk u tërhoqa prapa për të mos ju treguar gjithë këshillën e Perëndisë.

2 Timoteut 3:16*.....I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim me drejtësi,

Bakara 2:85*.....A e besoni një pjesë të librit, e tjetrën e mohoni?

Bakara 2:136 & 285*....136 Ju (besimtarë) thuani: "Ne i besuam All-llahut, atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit... atë që i është dhënë Musait, Isait dhe atë që iu është dhënë nga Zoti i tyre pejgamberëve, ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe ne vetëm atij i jemi bindur.

Al-i İmran 3:84 & 119.....84 Ne nuk bëjmë kurrfarë dallimi 119 Madje ju i besoni librat në tërësi,

Shënim: Myslimanët janë detyruar të besojnë në 4 libra: Tevrati, Zeburi, Injili dhe Kura'ni. Bibla përbën 90% nga këta.

14.

A do Perëndia që besimtarët sot të lexojnë dhe të binden të gjithë Librat e Shenjtë që Ai ka dërguar?

Bibla Po / Po Kurani

1 Timoteut 4:15-16.....15 Kujdesu për këto gjëra dhe kushtoj atyre tërësisht, që përparimi yt të jetë i dukshëm për të gjithë. 16 Ruaje veten tënde dhe mësimin, qëndro në këto gjëra, sepse, duke vepruar kështu, do të shpëtosh veten dhe ata që të dëgjojnë.

2 Timoteut 2:15.....Mundohu të dalësh përpara Perëndisë si i sprovuar, si punëtor që nuk ka pse të turpërohet, që thotë drejt fjalën e së vërtetës.

Al-i İmran 3:79.....Bëhumi dijetarë të mësimëve të Zotit, ngase e keni mësuar njerëzve livrin dhe e keni studiuar atë.

Zumar 39:9....."A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?" Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim.

15.

A është bindja ndaj Fjalës së Perëndisë kushti kryesor që një person të marrë "bekim" në jetën e tij?

Bibla Po / Po Kurani

Ligji i Përtërirë 11:26-27....26 Shikoni, unë vë sot para jush bekimin dhe mallkimin; 27 bekimin në rast se u bindeni urdhërimeve të Zotit, Perëndisë tuaj, që sot ju përcaktoj;

Ligji i Përtërirë 28:13*....Zoti do të bëjë që të jesh koka dhe jo bishti, dhe do të jesh gjithnjë lart dhe kurrë poshtë, në rast se u bindesh urdhërimeve të Zotit, Perëndisë tënd, që sot të urdhëron t'i respektosh dhe t'i zbatosh në praktikë.

Ligji i Përtërirë 30:19.... që unë të kam vënë përpara jetës dhe vdekjes, bekimit dhe mallkimit; zgjidh, pra, jetën që të mund të jetoni ti dhe pasardhësit e tu,

Bakara 2:2-4*....2 Ky është libri në të cilin nuk ka dyshim, udhëzues për ata që frikësohen (nga All-llahu). 4 Dhe ata të cilët e besojnë atë që t'u shpall Ty, dhe atë që është shpallur para teje, dhe të cilët për ahiretin (botën tjetër) janë të bindur.

16.*

A e vendosin veten nën mallkimin e të qenët jobesimtarë njerëzit që nuk pranojnë ta lexojnë Biblën e t'i binden asaj? (Kâfir)

Bibla Po / Po Kurani

Jeremia 11:3*....I mallkuar qoftë ai njeri që nuk dëgjon fjalët e kësaj besëlidhjeje,

Hebrenjte 12:25-29*....25 Shikoni se mos refuzoni atë që flet, sepse në qoftë se nuk shpëtuan ata që refuzuan të dëgjojnë atë që fliste si orakull mbi dhe, aq më pak do të shpëtojmë ne, po të mos refuzojmë të dëgjojmë atë që flet prej qiellit, 29 sepse Perëndia ynë është një zjarr që konsumon.

A'raf 7:36 & 40*....36 E ata që i konsideruan të rreme faktet tona dhe kryelartësi u larguan prej tyre, ata janë banues të zjarrit dhe në të janë përjetë.

Ankebut 29:46-47*....46 Ithtarët e librit mos i polemizoni ndryshe 47 kurse argumentet tona nuk i refuzon askush, përpos jobesimtarëve".

17.

A është pranuar se përmbledhja e Shkrimit është mbyllur me fundin e librit të Zbulesës?

Bibla Po / Jo Kurani

Zbulesa 22:18-19*....18 Unë i deklaroj kujtdo që dëgjon fjalët e profecisë së këtij libri, se nëse ndokush do t'i shtojë këtyre gjërave, Perëndia do të dërgojë mbi të plagët e përshkuara në këtë libër. 19 Dhe nëse dikush heq nga fjalët e librit të kësaj profecie, Perëndia do t'i heqë pjesën e tij nga libri i jetës nga qyteti i shenjtë, dhe nga gjërat që janë përshkruar në këtë libër.

Al-i İmran 3:19-20*.....19 Pa dyshim feja te All-llahu është Islami. U kundërshtuan ata që u është dhënë libri, pasi që u erdhi e vërteta, nga zilia mes vete. 20 Nëse janë nënshtruar, atëherë janë përudhur e nëse refuzojnë,

18.*

Që të quhet Fjala e Perëndisë, a është e nevojshme që Kur'ani të jetë në përputhje me Shkrimet historike sikurse janë regjistruar më parë në Bibël?

Bibla Po / Jo Kurani

1 Korintasve 14:32-33*.....32 Frymërat e profetëve u nënshtrohen profetëve, 33 sepse Perëndia nuk është Perëndi trazimi, por paqtimi si në të gjitha kishat e shenjtoreve.

Galatasve 1:8.....Por, edhe sikur ne ose një engjell i qiellit t'ju predikonte një ungjill të ndryshëm nga ai që ju kemi predikuar, qoftë i mallkuar.

2 Gjoni 1:9.....Kushdo që shkon tej dhe nuk qëndron në doktrinën e Krishtit, nuk ka Perëndi; kush qëndron në doktrinën e Krishtit, ka Atin dhe Birin.

Al-i İmran 3:85*.....E, kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kurrsesi nuk do ti pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit.

Ahzab 33:40*.....Muhammedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj por ai ishte i dërguari i All-llahut dhe vulë e të gjithë pejgamberëve, e All-llahu është i dijsëm për çdo send.

19.

A përmban Kur'ani mësimet themelore që janë krejtësisht të kundërta me mësimet e Biblës?

Bibla / Kurani

1 Gjoni 2:22-24*.....23 Kushdo që mohon Birin, s'ka as Atin; kushdo që njeh Birin, ka edhe Atin. 24 Ajo që ju, pra, dëgjuat nga fillimi le të qëndrojë në ju; në qoftë se ajo që dëgjuat nga fillimi qëndron në ju, edhe ju do të qëndroni në Birin dhe në Atin.

2 Gjoni 1:9.....Elkeen wat 'n oortreder is en nie aanhou in die leer van Die Gesalfde Een nie; God is nie in hom nie.

Shuara 26:196-197*....196 Dhe se ai (Kur'ani) është i përmendur edhe në librat e mëparshëm. 197 A nuk ishte për ata (për jobsimtarët mekas) argument, se atë e dinin dijetarët (ulemaja) e beni israilëve?

Fussilat 41:43*.....Ty nuk po të thuhet tjetër përveç asaj që u është thënë të dërguarve para teje.

20.

Është koncepti "frymëzim" ose "zbulesë" të njëjtë në Kur'an, me atë në Bibël?

Bibla / Kurani

2 Timoteut 3:16*.....I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim me drejtësi,

2 Pjetri 1:20-21*.....20 që asnjë profeci e Shkrimit nuk është objekt i interpretimeve të veçanta. 21 Sepse asnjë profeci nuk ka ardhur nga vullneti i njeriut, por njerëzit e shenjtë të Perëndisë kanë folur, të shtyrë nga Fryma e Shenjtë.

Nisa 4:163*.....Ne të frymëzuam ty me shpallje sikurse e patëm frymëzuar... Ibrahimin... Isain...

En'am 6:19 & 93.....19 Thuaj: "Cili send ka dëshminë më të madhe?" Thuaj: "All-llahu është dëshmues mes meje e jush, e mua më është shpallur ky Kur'an që me të t'ju tërheqë vërejtjen juve dhe atij që i komunikohet 93 E kush është më gabimtar i madh se sa ai që trillon rrenë ndaj Zotit, ose thotë: "Mua po më shpallet e nuk i është shpallur asgjë, ose se sa ai që thotë: "Do të thur diçka të ngjajshme me atë që e ka zbritur All-llahu".

Shënim: Krahaso: Shuara 26:192-197 & Fussilet 41:43.

21.

A duhet judenjtë apo të krishterët të pranojnë Kur'anin si një Libër të Shenjtë?

Bibla Jo / Po Kurani

Ligji i Përtërirë 18:20-22*.....20 Por profeti që pretendon të thotë në emrin tim një gjë për të cilën unë e kam urdhëruar ta thotë ose që flet në emër të perëndive të tjera, ai profet do të vritet".

Isaia 8:20*.....Wat die wet en die getuienis betref, as hulle nie praat volgens hierdie woord nie, is dit omdat hulle geen omkoopgeskenk daarvoor ontvang het nie.

Shu'ara 26:196-197.....196 Dhe se ai (Kur'ani) është i përmendur edhe në librat e mëparshëm. 197 A nuk ishte për ata (për jobsimtarët mekas) argument, se atë e dinin dijetarët (ulemaja) e beni israilëve?

22.

Pasi Perëndia të dërgonte një Libër të Shenjtë, a do ta ndjente Ai nevojën për të anuluar ose shfuqizuar disa prej vargjeve të tij? (Mensuh & Nesih)

Bibla Jo / Po Kurani

Psalmet 89:34*.....Nuk do të shkel besëlidhjen time dhe nuk do t'i ndryshoj fjalët që kanë dalë nga goja ime. **Luka 16:17.....**Por është më lehtë që të mbarojnë qielli dhe toka, se sa të bjerë poshtë qoftë edhe një pikë nga ligji.

Gjoni 10:35*.....dhe Shkrimi nuk mund të bjerë poshtë

Bakara 2:106*.....Ne nuk abrogojmë (pezullojmë) asnjë nga argumentet tona, apo ta hedhim në harresë e të mos sjellim edhe më të dobishëm se ai, ose të ngjashëm me te. A nuk e ke ditur se All-llahu është i plotfuqishëm për çdo send?

Ra'd 13:39*.....All-llahu shlyen (nga ajo evidencë) çka të dojë, e edhe forcon (çka të dojë). Vetëm te Ai është baza e librit (Levhi Mahfudhi).

Nahl 16:101*.....Kur një ajet e zavendësojmë me një ajet tjetër - e All-llahu di më së miri se çka shpall - ata thonë: "Ti (Muhammed) je vetëm trillues"

İsra 17:86*.....Po të kishim dëshiruar, Ne do ta shlyenim nga gjoksi yt atë që të shpallëm ty,

23.*

Nëse Kur'ani erdhi nga Zoti i Botëve dhe u miratua nga një grup demonësh, a do të ishte kjo shenjë e mire se ka ardhur nga Perëndia?

Bibla Jo / Po Kurani

Gjoni 14:30*.....Nuk do të flas më gjatë me ju, sepse po vjen princi i kësaj bote dhe ai nuk ka asgjë në mua;

2 Korintasve 4:3-4*.....Dhe, në qoftë se ungjilli ynë është ende i mbuluar me vel, ai është i mbuluar për ata që humbin, të cilëve perëndia i këtij shekulli ua verboi mendjet e atyre që nuk besojnë, që drita e ungjillit të lavdisë së Krishtit,

Fatih 1:2....Falënderimi i takon All-llahut , Zotit të botërave !

Yunus 10:37.... Nuk është e logjikshme të mendohe se ky Kur'an është i trilluar prej dikujt pos All-llahut... Nuk ka farë dyshimi se është (i zbritur) nga Zoti i botëve.

Ahkaf 46:29-30.....29 (Përkujto) Kur disa prej exhinëve i drejtuam te ti që të dëgjojnë Kur'anin 30 Thanë: "O populli ynë, në dëgjuam një libër të shpallur pas Musait, që vërteton atë para tij, që udhëzon në të vërtetën dhe në rrugën drejtë!"

24.

A duhet të jetë e nevojshme që një Libër i Shenjtë të theksojë vazhdimisht se nuk është nga djalli?

Bibla Jo / Po Kurani

Mateu 7:15-20*.....Ruhuni nga profetët e rremë...

Gjoni 8:44-49*.....46 Cili nga ju më bind për mëkat? Nëse flas të vërtetën, përse nuk më besoni?

Nahl 16:98*.....Kur të lexosh Kur'anin kërko mbrojtjen e All-llahut prej djallit të mallkuar.

Sebe 34:8 & 46*.....8 A është duke krijuar gënjeshtër ndaj All-llahut, apo e ka kapur çmendia?"

Tekvir 81:22 & 25*.....22 Nuk është i marrë shoku juaj (Muhammedi)! 25 Dhe ai (Kur'ani) nuk është thënie e djallit të mallkuar!

Shënim: Muhamedi mohoi shpesh që ishte sunduar nga demone: 15:6-7, 23:70, 37:36, 44:14, 51:50-52, 68:51.

Perëndia dhe Allahu

25.*

A besojnë judenjtë, të krishterët dhe muslimanët se ka vetëm "një" Perëndi të vërtetë?

(Monoteizëm ose Vahdet-i Vyjud)

Bibla Po / Po Kurani

Ligji i Përtërirë 6:4*.....Dëgjo, Izrael, Zoti, Perëndia ynë, është një i vetëm.

Efesianeve 4:4-6.....4 Është një trup i vetëm dhe një Frym i vetëm 5 Është një Zot i vetëm, 6 një Perëndi i vetëm dhe Atë i të gjithëve, që është përmbi të gjithë,
1 Timoteut 2:5-6.....5 Në fakt një është Perëndia,
Jakobi 2:19....Ti beson se ka vetëm një Perëndi. Mirë bën; edhe demonët besojnë dhe dridhen.

Bakara 2:163*.....Zoti jua (që meriton adhurim) është një, All-llahu, nuk ka zot pos Atij...

Nisa 4:87 & 171*.....87 Për All-llahun, që s'ka tjetër pos Tij... 171 All-llahu është vetëm një All-llahu;

Maide 5:73.....S'ka në gjithësi tjetër pos një All-llahu,

Kasas 28:70....Ai është All-llahu, nuk ka Zot tjetër pos Tij

Ihlas 112:1.....Thuaj: Ai, All-llahu është Një!

26.*

A janë shumë nga atributet e karakterit dhe natyrës së Allahut të gjendura në Kur'an në përputhje me atributet e Perëndisë të gjendura në Bibël? (Esmayl-Husna)

Bibla Po / Po Kurani

Isaia 40:28*.....Nuk e di ti, vallë, nuk e ke dëgjuar? Perëndia i përjetësisë, Zoti, krijuesi i kufijve të tokës, nuk mundohet dhe nuk lodhet, zgjuarësia e tij është e panjohshme.

Bakara 2:255*.....All-llahu - s'ka zot pos Tij. I Gjalli, Vigjiluesi. Nuk e ze të koturit, e as gjumi. E Tija është ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë.

Hashr 59:23*.....Ai është All-llahu, pos të Cilit nuk ka zot tjetër, Sunduesi, i Shenjti, i Pastërti (prej të metave që i mvishen), Siguruesi, Mbikëqyrësi, i Plotfuqishmi, Mbizotëruesi, i Madhërishmi.

27.

A janë "Perëndia" e Biblës dhe "Allahu" i Kur'anit të njëjtë?

Bibla Jo / Po Kurani

Eksodi 3:14.....Perëndia i tha Moisiut: "UNÉ JAM AI QÉ JAM". Pastaj tha: "Do t'u thuash kështu bijve të Izraelit: "UNÉ JAM-i më ka dërguar tek ju".

1 Gjoni 5:20*.....Jezu Krisht; ky është i vërteti Perëndi dhe jeta e përjetshme.

Ankebut 29:46*.....Ithtarët e librit mos i polemizoni ndryshe (kurr i thirrni në fenë tuaj) vetëm ashtu si është më së miri, përveç atyre që janë mizorë dhe thuajuni: "Ne i besuam asaj që na u zbrit dhe që u zbrit juve dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një, dhe se ne i jemi dorëzuar Atij.

Safat 37:126.....All-llahun, Zotin tuaj e të prindërve tuaj të hershëm!!"

Shënim: Krahaso: Shura 42:15 & Duhan 44:8.

28.

A është "Jahueh" emri i përjetshëm dhe i pandryshueshëm i Perëndisë?

Bibla Po / Jo Kurani

Eksodi 3:15*....."Zoti, Perëndia i etërve tuaj, Perëndia i Abrahamit, Perëndia i Isakut dhe Perëndia i Jakobit më ka dërguar tek ju. Ky është emri im përjetë. Ky ka për të qenë gjithnjë emri im me të cilin do të kujtohem nga të gjitha breznitë".

Gjoni 8:58*.....Jezusi u tha atyre: "'Në të vërtetë, në të vërtetë unë po ju them: para se të kishte lindur Abrahami, unë jam'".

A'raf 7:180*.....All-llahu ka emrat më të mirë, andaj Atë thirrnie me ata e hiquni nga ata

Isra 17:110*.....Thuaj: "Thërrisni: All-llah ose thërrisni Er Rrahman, me të cilindo që ta thërrisni (me këta dy emra), emrat e Tij janë më të bukurit.

Shënim: Emri i veçantë dhe të përjetshëm "Jahve" është përdorur 6823 herë në Bibël, por nuk gjendet fare mes të 99 emrave të Perëndisë (Esmaul-Husna) në Kura'n. Krahaso: Taha 20:8, Rahman 55:78, Hashr 59:24.

29.

A ka vargje në Librat e Shenjtë që shprehin se Perëndia është "i Shenjtë"? (el-Kuddus)

Bibla Po / Po Kurani

Isaia 6:3...."I Shenjtë, i shenjtë, i shenjtë është Zoti i ushtrive. Tërë toka është plot me lavdinë e tij".

Isaia 40:25....Me kë kërkoni, pra, të më ngjasoni, që të jem baras me të?, thotë i Shenjti.

Isaia 57:15*....Sepse kështu thotë i Larti dhe i Madhërismi që banon përjetësinë dhe emri i të cilit është i "Shenjti": "Unë banoj në vendin e lartë dhe të shenjtë dhe..."

Gjoni 17:11....unë po vij te ti. O Atë i shenjtë

Zbulesa 4:8*....''I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë është Zoti Perëndi, i Plotfuqishmi, që ishte, që është dhe që do të vijë!''.

Hashr 59:23*.....Ai është All-llahu, pos të Cilit nuk ka zot tjetër, Sunduesi, i Shenjti...

Jum'a 62:1*.....Ç'farë ka në qiej dhe ç'ka në tokë bën tesbih All-llahun, Sunduesin, të Pastërin nga çdo e metë, të Fuqishmin e të Urtin.

Shënim: Këtë veçanti përmendet vetëm dy herë në Kura'n, por gjendët më shumë së 450 herë në Bibël.

30.

Mes cilësive të karakterit dhe natyrës së Perëndisë, a e shfaq Perëndia Vetën si "Ati"?

Bibla Po / Jo Kurani

Isaia 63:16*....Sepse ti je ati ynë.. Ti, o Zot, je ati ynë, Çliruesi ynë, emri yt vazhdon ngaherë.

Mateu 5:45 & 48....45 për të qenë bij të Atit tuaj, që është në qiej.. 48 Jini, pra, të përkryer, ashtu siç është i përsosur Ati juaj, që është në qiej''.

Gjoni 8:41....ne kemi një Atë të vetëm: Perëndinë''.

En'am 6:101*....Ai (All-llahu) është që krijo (pa kurrfarë shembulli) qiejt dhe tokën (e duke qenë i tillë), e si do të ketë Ai fëmijë kur nuk pati bashkëshorte?

Furkan 25:2.... Ai nuk ka as fëmijë e as nuk ka shok në sundimin e Tij.

Jinn 72:3*....nuk është që ka as grua, as fëmijë.

31.*

A është Perëndia krenar dhe a është krenaria cilësi e karakterit të Perëndisë? (el-Mytekebbir)

Bibla Jo / Po Kurani

Psalmet 101:5.....nuk do të duroj njeriun hundëpërpjetë dhe zemërkrenar.

Fjalët e urta 6:16-17.....Zoti i urren këto gjashtë gjëra, madje shtatë janë të neveritshme për të: sytë krenare, gjuha gënjeshtare...

Isaia 57:15....."Unë banoj në vendin e lartë dhe të shenjtë dhe bashkë me atë që është i penduar dhe i përulur nga fryma, për të ngjallur frymën e të përulurve, për të ngjallur frymën e të penduarve.

1 Gjoni 2:16*.....lakmia e syve dhe krenaria e jetës, nuk vjen nga Ati, por nga bota.

Hashr 59:23*.....Ai është All-llahu, pos të Cilit nuk ka zot tjetër, Sunduesi, i Shenjti, i Pastërti (prej të metave që i mvishen) , Siguruesi, Mbikëqyrësi, i Plotfuqishmi, Mbizotëruesi , i Madhërishmi.

32.*

Në mesin e karakterit dhe natyrës atributet e Zotit, që Perëndia të zbulojë Vetën si "Shpëtimtarin"?

Bibla Po / Jo Kurani

Isaia 43:3 & 11*.....3 Sepse unë jam Zoti, Perëndia yt, i Shenjti i Izraelit, Shpëtimtari yt. 11 Unë, unë jam Zoti dhe përveç meje nuk ka Shpëtimtar tjetër.

Osea 13:4.....ti nuk duhet të pranosh tjetër Perëndi veç meje dhe nuk ka tjetër Shpëtimtar jashtë meje.

Luka 2:11*.....sepse sot në qytetin e Davidit lindi për ju një Shpëtimtar, që është Krishti, Zoti.

Titit 1:4.....mëshirë dhe paqe prej Perëndisë, Atit, dhe prej Zotit Jezu Krisht, Shpëtimtarit tonë.

Titit 2:10-13.....13 duke pritur shpresën e lume dhe të shfaqurit e lavdisë të të madhit Perëndi dhe të Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht,

Juda 1:25.....të vetmit Perëndi të ditur, Shpëtimtarit tonë, i qoftë lavdi, madhësi,

Shënim: Emërtimi i Zotit si të qënurit "Shpëtimtar" gjenden 39 herë në Bibël, por nuk gjenden në Kura'n.

33.*

Në Librat e Shenjtë, kur Perëndia flet për Vetën, a flet ndonjëherë në vetën i parë shumës "Ne"?

Bibla Po / Po Kurani

Zanafilla 1:26*.....Pastaj Perëndia tha: "Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë dhe në ngjasim me ne,

Zanafilla 11:6-7....6 Dhe Zoti tha... 7 O burra, të zbresim pra atje poshtë dhe të ngatërrojmë gjuhën e tyre, në mënyrë që njëri të mos kuptojë të folurën e tjetrit".

Isaia 6:8.....Pastaj dëgjova zërin e Zotit që thoshte: "Kë të dërgoj dhe kush do të shkojë për ne?".

Gjoni 17:11*.....O Atë i shenjtë, i ruaj ata në emrin tënd, ata që më ke dhënë, që të jenë një sikurse ne!

Vakia 56:57-59, 64, 69 & 72*.....57 Ne u kemi krijuar juve, e përse nuk pranoni (ringjalljen)? 58 A më tregoni për farën që e dredhni, 59 A ju e krijoni atë, apo Ne jemi që e krijojmë?

Ënسان 76:23.....Ne të shpallëm ty Kur'anin në intervale (pjesë-pjesë).

Shënim: Teofani të tjerë në Bibël: Zan. 12:7-9, 18:1-33, 32:22-30, Eks. 3:2-4:17, 24:9-11, Lip. 31:14-15, Job 38-42.

34.*

A është koncepti i "Trinisë" i pranueshëm? (Ati, Biri, Fryma e Shenjtë)

Bibla Po / Jo Kurani

Mateu 28:19-20*.....19 Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë,

Efesianeve 4:4-6*.....4 Është një trup i vetëm dhe një Frymë i vetëm.. 5 Është një Zot i vetëm.. 6 një Perëndi i vetëm dhe Atë i të gjithëve, që është përmbi të gjithë, në mes të të gjithëve dhe në ju të gjithë.

Nisa 4:171.....e Tij e mos thoni: "Tre" (trini). Pushoni (së thëni), se është më mirë për ju.

Maide 5:72-73.....Zotin tim dhe Zotin tuaj, sepse ai që i përshkruan Zotit shok, All-llahu ia ka ndaluar (ia ka bërë haram) atij Xhennetin dhe vendi i tij është zjarri.

35.*

A do ta akuzonte Perëndia padrejtësisht Jezusin se kishte bërë diçka gabim ose a do ta gënjente Jezusi Perëndinë për të mbuluar diçka që e kishte bërë gabim?

Bibla Jo / Po Kurani

Gjoni 8:46*.....Cili nga ju më bind për mëkat? Nëse flas të vërtetën, përse nuk më besoni?

Titit 1:2.....në shpresën e jetës së përjetshme, të cilën Perëndia, që nuk gënjen, e premtoi para të gjitha kohërave,

1 Pjetri 2:21-23*.....21 Sepse për këtë ju u thirrët, sepse edhe Krishti e vuajti për ne, duke ju lënë një shembull, që të ecni pas gjurmës së tij. 22 "Ai nuk bëri asnjë mëkat dhe nuk u gjet asnjë mashtrim në gojë të tij".

Ma'ida 5:116*.....Dhe kur All-llahu tha: "O Isa, bir i Merjemes, a ti njerëzve u the: "Më besoni mua dhe nënës time dy zota pos All-llahut!?" (Isai) Tha: "Larg asaj të mete je Ti (o Zoti im). Nuk më takon mua ta them atë që s'është e vërtetë. Ta kisha thënë unë atë, ti do ta dije. Ti e di ç'ka në mua, e unë e di ç'ka në Ty. Ti je më i dijsmi i të fshehtave!"

36.*

A është Perëndia i largët dhe i pakuptueshëm, duke e shfaqur shumë rrallë fuqinë e Tij të madhe e duke lënë shumë rrallë gjurmë në historinë njerëzore?

Bibla Jo / Po Kurani

Eksodi 13:21*.....Dhe Zoti shkante para tyre, ditën në një kolonë resh për t'i udhëhequr në rrugë, dhe natën në një kolonë zjarri për t'u bërë atyre dritë, që të mund të ecnin ditën dhe natën.

1 Samuelit 12:16.....Prandaj tani ndaluni dhe shikoni këtë gjë të madhe që Zoti do të bëjë para syve tuaj.

En'am 6:37-38*.....Dhe thanë : "Përse të mos i zbret atij (Muhammedit) një mrekulli nga Zoti i tij?" Thuaj: "S'ka dyshim se All-llahu ka fuqi t'ia zbresë një mrekulli, por shumica e tyre nuk e dinë (se çka do t'i gjente më pas).

37.

A u është shfaqur Perëndia ndonjëherë në mënyrë të dukshme njerëzve në tokë?

(Teofani ose Ru'jetullah)

Bibla Po / Jo Kurani

Eksodi 33:11 & 18-23*.....11 Kështu Zoti fliste me Moisiun ballë për ballë, ashtu si një njeri flet me mikun e tij; 18 Atëherë Moisiu tha: "Tregomë lavdinë tënde!". 23 pastaj do ta tërheq dorën dhe ti do të më shikosh nga kurrizi; por fytyra ime nuk mund të shihet".

Numbers 12:7-8....7 me shërbëtorin tim Moisi... 8 Me të unë flas sy për sy... dhe jo me shprehje të errëta;

En'am 6:103*.....Tëparët (e njerëzve) nuk mund ta përfshinë Atë... Ai është shumë i kujdesshëm,

A'raf 7:143*.....Msai... ai tha: "Zoti im! Më mundëso pamjen tënde e të shikoj!" Ai (Zoti) i tha: "Ti nuk ke mundësi të më shohësh,

Hajj 22:63....All-llahu është i kujdesshëm, mirënjohës.

Lokman 31:16....All-llahu është i butë dhe hollësisht
Shënim: Theophanies të tjera në Bibël: Zanafilla 12:7-9; 18:1-33; 32:22-30; Eksodi 3:2-4:17; 24:9-11; Ligji i Përtërirë 31:14-15; Jobi 38-42.

38.*

A u flet Perëndia sot njerëzve në mënyrë të drejtpërdrejtë përveç zbulesës së Tij të shkruajtur?

Bibla Po / Jo Kurani

Joeli 2:28*.....Mbas kësaj do të ndodhë që unë do të përhap Frymën tim mbi çdo mish; bijtë tuaj dhe bijat tuaja do të profetizojnë,

1 Korintasve 14:1-4 & 24-25*.....Kërkoni dashurinë dhe lypni me zemër të zjarrtë dhuntitë frymërore, por sidomos që të mund të profetizoni,

Tevbe 9:31*.....I lartë është Ai nga çka i shoqërojnë.

Shura 42:51*.....Nuk ka asnjë njeri që t'i ketë folur All-llahut ndryshe, vetëm se me anën e frymëzimit, ose pas ndonjë perdeje, ose t'i dërgojë të dërguar (melek),

39.*

A dëshiron Perëndia i pafund të ketë një marrëdhënie të ngushtë me dashuri me njerëzit e vdekshëm aq sa njerëzit të quhen "Fëmijët e Perëndisë"?

Bibla Po / Jo Kurani

Osea 1:10*.....Dhe do të ndodhë që në vend që t'u thuhet atyre: "Ju nuk jeni populli im", do t'u thuhet atyre: "Jeni bijtë e Perëndisë së gjallë".

Galatasve 4:6.....Dhe, duke qenë se jeni bij, Perëndia dërgoi Frymën e Birit të tij në zemrat tuaja që thërret: "'Abba, Atë!'".

1 Gjoni 3:1-2.....1 Shikoni ç'dashuri të madhe na dha Ati, që të quhemi bij të Perëndisë. Prandaj bota nuk na njeh, 2 Shumë të dashur, tani jemi bij të Perëndisë,

Maide 5:18*.....Jehuditë dhe të krishterët thanë: "Ne jemi bijtë e All-llahut dhe të dashurit e Tij". Thuaju: "E pse pra, Ai ju dënon me mëkatet tuaja?" Jo, ju jeni njerëz që Ai ju krijoi.

Shënim: Edhe me qenë së Kura'ni mohon që njerëzit mund të bëhën Bij të Perëndisë, tregohet që Perëndia është shumë pranë njerëzve. Krahaso: Enfal 8:24; Hud 11:90 & 92; & Kaf 50:16.

40.*

A është dashuria e Perëndisë pa kushte? (el-Vedud)

Bibla Po / Jo Kurani

Romakeve 5:8*.....Por Perëndia e tregon dashurinë e tij ndaj nesh në atë që, kur ende ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne.

1 Gjoni 4:8-10*.....8 Perëndia është dashuri. 10 Në këtë është dashuria: jo se ne e kemi dashur Perëndinë, por që ai na ka dashur ne dhe dërgoi Birin e tij për shlyerjen e mëkateve tona.

Bakara 2:195.....vërtetë All-llahu i do bamirësit.

Nisa 4:107.....All-llahu nuk e do atë që është gënjeshtar e mëkatar.

Al-i Imran 3:169.....All-llahu ido ata që mbështeten.

Rum 30:45.....vërtet, Ai nuk i do jobesimtarët.

Saf 61:4..... All-llahu i do ata që luftojnë në rrugën e Tij të rreshtuar si të jetë ndërtesë e fortifikuar.

41.*

A i konsideron Perëndia besimtarët thjeshtë si skllëverit e Tij apo shërbëtorë?

Bibla Jo / Po Kurani

Gjoni 15:15*.....Unë nuk ju quaj më shërbëtorë, sepse shërbëtori nuk e di ç'bën i zoti; por unë ju kam quajtur miq,

1 Pjetri 2:5 & 9-10*.....5 edhe ju... një priftëri e shenjtë, 9 Julle is 'n gekose nasie, 10 ju, që dikur nuk ishit një popull, kurse tani jeni populli i Perëndisë;

Sad 38:83.....përveç atyre që janë të singertë nga robërit e Tu!"

Zulmer 39:16-17*.....16 "Me këtë All-llahu i frikëson robërit e Vet: "O robërit e Mi, kinie frikë (dënimin)!" 17 e ti përgëzoj robërit e Mi!

Shura 42:19*.....All-llahu është shumë bamirës për robërit e vet;

Shënim: Krahaso: Zanafilla 1:26, Gjoni 1:12, Zbulesa 21:12 & 22:17.

42.*

A bën Perëndia dallime mes njerëzve dhe a i parapëlqen Ai disa më shumë se të tjerët?

Bibla Jo / Po Kurani

Marku 12:14....."Mësues, ne e dimë se ti je i vërtetë pa pyetur për njeri, sepse nuk merr parasysh dukjen e njerëzve, por u mëson udhën e Perëndisë sipas së vërtetës

Galatasve 3:28*.....Nuk ka as Jude, as Grek, nuk ka as skllav as të lirë, nuk ka as mashkull as femër, sepse të gjithë jeni një në Jezu Krishtin.

Efesianeve 6:9*.....dhe se tek ai nuk ka asnjë anësi.

En'am 6:165*.....Ai është që ju bëri sundues (zëvendësues) në tokë (pas shkatërrimit të atyre që ishin më parë) dhe lartësoi në një shkallë më të lartëdisa nga ju mbi të tjerët,

Nahl 16:71 & 75*.....71 All-llahu favorizoi disa prej jush mbi disa tjerë në furnizim. 75 A janë pra ata të dy të barabartë?

Ahzab 33:50.....O ti Pejgamber, Ne të kemi lejuar gratë, të cilave u ke dhënë shpërblimin e kurorës... duke qenë kjo (rast) vetëm për ty e jo edhe për besimtarët.

43.*

A i urren Perëndia disa mëkatarë në mënyrë të veçantë dhe dëshiron t'i çojë disa prej tyre në ferr?

Bibla Jo / Po Kurani

Ezekieli 18:23 & 32*.....18 A ndjej vallë gëzim nga vdekja e të pabesit?", 32 Unë në fakt nuk ndjej asnjë kënaqësi me vdekjen e atij që vdes" thotë Zoti, Zoti. "Ndërroni rrugë, pra, dhe do të jetoni".

2 Pjetri 3:9*.....Zoti nuk... por është i durueshëm ndaj nesh, sepse nuk do që ndokush të humbasë, por që të gjithë të vijjnë në pendim.

Maide 5:41*.....Janë ata të cilëve All-llahu nuk desh i t'iu pstrojë zemrat (prej kufrit).

A'raf 7:179.....Ne krijuam shumë nga xhinët e njerëzit për Xhehennem. Ata janë si kafshët...

Tevbe 9:55*.....All-llahu do vetëm t'i dënojë me to në jetën e kësaj bote e t'ju nxjerrë shpirtërat duke qenë ashtu qafira.

44.

A është Perëndia autori i "së mirës" dhe i "së keqes" dhe a është Ai përgjegjës për kryerjen e të dyjave? (Hajir dhe Sher)

Bibla Jo / Po Kurani

Jeremia 29:11*.....Sepse unë i njoh mendimet që kam për ju", thotë Zoti, "mendime paqeje dhe jo të së keqes...

Jakobi 1:13*.....Askush kur tundohet të mos thotë: "'Jam tunduar nga Perëndinë'", sepse Perëndia nuk mund të tundohet nga e keqja, dhe ai vet nuk tundon asnjëri.

Bakara 2:26.....Ai me të lajthitë shumë...

Maide 5:14*.....nesara.. andaj Ne kemi ndërsyer armiqësinë e urrejtjen ndërmjet tyre deri në dtën e kijametit.

Enbiya 21:35*.....në shenjë sprove ju sprovojmë me vështirësi e kënaqësi,

Nisa 4:78-79*.....E nëse i qëllon ata ndonjë e keqe: Thuaju: "Të gjitha janë nga All-llahu!"

Shënim: Në Bibël ka ngjarje ku Perëndia lejon kundërshtime apo vështirësi (jo ligësi me mënyrë morale) që t'i ndodhin njeriut: Isa. 45:7, Jer. 4:6 & Am. 3:6. Kurse Satani përcaktohet si autori i ligësisë: Gj. 8:44, 1 Gj. 3:8

45.

A është Allahu "mashtuesi" më i madh? (Makara)

Bibla Jo / Po Kurani

Mikea 2:1.....Mjerë ata që bluajnë në mendje paudhësi dhe projektojnë të keqen mbi shtretërit e tyre;

Zechariah 8:17*..... Askush të mos kurdisë në zemër të vet ndonjë të keqe kundër të afërmit të vet dhe mos pëlqeni betimin e rremë, sepse të gjitha këto gjëra unë i urrej, thotë Zoti".

Al-i İmran 3:54*.....All-llahu është asgjësuesi më i fuqishëm kundër atyre që bëjnë dredhi.

Ra'd 13:42*....Edhe ata (jobesimtarët) para tyre (idhujtarëve) bënë intrigë, po e gjithë intriga është e nënshtruar dëshirës së All-llahut,

Shënim: Në Bibël sajime kompletesh dhe intrigash janë caktuar si gjë e keqe dhe këto veprimet janë lidhur me Satanin, jo me Perëndinë: Krahaso: Zanafilla 3:1, Ester 9:25, Psalmet 21:11, Psalmet 36:4, Fjalët e urta 1:30, 2 Korintasve 11:13-15, Efesianeve 6:11, 1 Pjetri 5:8-9, 2 Gjoni 1:7.

46.

A është Perëndia përgjegjës për shtirjen e armiqësisë dhe urrejtjes mes njerëzve të besimeve të ndryshme?

Bibla Jo / Po Kurani

Jeremia 29:11*.....Sepse unë i njoh mendimet që kam për ju", thotë Zoti, "mendime paqeje dhe jo të së keqes, për t'ju dhënë një të ardhme dhe një shpresë.

Habakuku 1:13.....Ti i ke sytë tepër të pastër për të parë të keqen dhe nuk e shikon dot paudhësinë.

Bakara 2:10..... Në zemrat e tyre ka sëmundje, pra All-llahu ua shton sëmundjen,

Nisa 4:88.....a mos doni ta vini në rrugë të drejtë atë që All-llahu e ka humbur? Për atë që All-llahu e ka humbur, nuk do të gjeni rrugë!

Maide 5:14*.....dhe të atyre që thanë: "Ne jemi nesara"... andaj Ne kemi ndërsyer armiqësinë e urrejtjen ndërmjet tyre deri në dtën e kijametit.

Maide 5:64*.....Jehuditë... Ne ndërmjet tyre hodhëm armiqësi dhe urrejtje që do t'u vazhdojë deri në ditën e kijametit.

47.*

A është qëllimi i Zotit të ngurtësojë zemrat e disa njerëzve dhe t'i çojë në udhë të gabuar?

Bibla Jo / Po Kurani

Mateu 18:11-14*.....11 Sepse Biri i njeriut erdhi për të shpëtuar atë që qe humbur. 14 Kështu është dëshira e Atit tuaj që është në qiej, që asnjë nga këta të vegjël të mos humbasë''.

1 Timoteut 2:3-4*.....3 Sepse kjo është e mirë dhe e pëlqyer përpara Perëndisë, Shpëtimtarit tonë, 4 i cili dëshiron që gjithë njerëzit të shpëtohen dhe t'ia arrijnë njohjes të së vërtetës.

Baqara 2:7, 15 & 26*.....7 All-llahu vëndoi vulë në zemrat e tyre dhe vëshët e tyre, ndërsa në të pamurit e tyre ka një perde, 15 All-llahu tallet me ta, dhe ua shton të këqiat duke i lënë të bredhin. 26 Ai me të lajthitë shumë,

Nisa 4:119.....Do t'i (shmang nga e vërteta), do t'i bëjë të shpresojnë në gjëra të kota;

A'raf 7:186.....Për atë që All-llahu e la në humbje, s'do tëketë udhëzues, dhe ata do t'i lë të bredhin në vrazhdësinë e tyre.

48.

A është Perëndia ndonjëherë tekanoz në karakter dhe sjellje?

Bibla Jo / Po Kurani

Numbers 23:19.....Kur ka thënë një gjë, nuk do ta bëjë? Ose kur ka shpallur një gjë, nuk do ta kryejë?

Psalmet 119:90.....Besnikëria jote vazhdon brez pas brezi

Malachi 3:6.....Unë jam Zoti, nuk ndryshoj;

2 Timoteut 2:13*.....Nëse jemi të pabesë, ai mbetet besnik, sepse ai nuk mund të mohojë vetveten.

Titit 1:2*.....të cilën Perëndia, që nuk gënjen,

Hud 11:106-107*.....106 e për sa u përket atyre fatkëqinjve, ata janë në zjarr, 107 Aty janë përgjithmonë, sa të jenë qiejt dhe toka, përveç atë çka do Zoti yt, vërtet Zoti yt punon çka dëshiron.

Hajj 22:14*.....All-llahu punon atë që dëshiron.

Fatir 35:8.....Në të vërtetë, All-llahu e largon nga e vërteta atë që do dhe Ai e udhëzon atë që do,

49.*

A është e ndaluar të biesh përmbys para ndokujt tjetër përveç Perëndisë?

Bibla Po / Po Kurani

Eksodi 20:2-5*.....2 Unë jam Zoti, Perëndia yt, 3 Nuk do të kesh perëndi të tjerë para meje. 5 Nuk do të përkulesh para tyre dhe as do t'i shërbesh, sepse unë, Zoti, Perëndia yt, jam një Perëndi xheloz

Ligji i Përtërirë 5:7-9*.....7 Nuk do të kesh perëndi të tjera përpara meje. 9 Nuk do të biesh përmbys para tyre dhe nuk do t'u shërbesh, sepse unë, Zoti, Perëndia yt, jam një Perëndi xhelos

Zbulesa 22:8-9*.....8 rashë për ta adhuruar përpara këmbëve të engjëllit që m'i tregonte këto gjëra. 9 Dhe ai më tha: "'Ruaju se e bën! Sepse unë jam bashkëshërbëtori yt dhe i vëllezërve të tu, profetë, dhe të atyre që i ruajnë fjalët e këtij libri. Adhuro Perëndinë!''.

Isra 17:23*.....Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuroni tjetër pos Tij,

Zariyat 51:56*.....Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë.

50.*

A i urdhëroi Perëndia të gjithë engjëjt të binin përmbys para Adamit?

Bibla Jo / Po Kurani

Isaia 14:12-17*.....12 Vallë, si ke rënë nga qielli, o Lucifer, bir i agimit? 13 Ti thoshnje në zemrën tënde: "Unë do të ngjitem në qiell, do të ngre fronin tim përmbi yjet e Perëndisë; 14 do të jem i ngjashëm me Shumë të Lartin".

Ezekieli 28:11-19*.....15 Ti ishe i përsosur në rrugët e tua qysh nga dita që u krijove, deri sa nuk u zbulua te ti çoroditja. 17 Zemra jote ishte ngritur për bukurinë tënde; ke korrptuar diturinë tënde për shkak të shkëlqimit tënd.

Bakara 2:31-34*.....34 E kur u thamë engjëjve: përluni (bini në sexhde) Ademit, ata menjëherë iu përlën, me përjashtim të iblisit (djallit). Ai rrefuzoi dhe u mbajtë në të madh dhe u bë pabesimtar.

Fryma e Shenjtë, Engjëjt, Demonët dhe Satani

51.*

A pranohet "Fryma e Shenjtë" si Perëndi?

(Ruh-yl Kudys)

Bibla Po / Jo Kurani

Psalmet 139:7.....Ku do të mund të shkoja larg Frymës sate, ose ku do të mund të ikja larg pranisë sate?

Gjoni 4:24.....Perëndia është Frymë, dhe ata që e adhurojnë duhet t'a adhurojnë në frymë dhe në të vërtetën''.

Veprat 5:3-4*.....3 Por Pjetri i tha: 'Anania, pse Satani ta mbushi zemrën që të gënjesh Frymën e Shenjtë.. 4 Ti nuk ke gënjyer njerëzit, por Perëndinë!''.

Bakara 2:87 & 253*.....87 Isait, birit të Merjemës i dhamë argumente (mrekulli) dhe e fuqizua me (Xhibrilin) shpirtin e shenjtë.

Maide 5:110*.....All-llahu (atë ditë) i thotë: "O Isa, bir i merjemes, përkujtoj të mirat e Mia ndaj teje dhe ndaj nënës sate, kur të fuqizova me shpirtin e shenjtë (Xhibrilin),

Shënim: Gjendën 113 vende në Bibël ku Fryma e Shenjtë përcaktohet si të qënurit Perëndi.

52.*

A e ka Fryma e Shenjtë fuqinë për të krijuar?

Bibla Po / Jo Kurani

Zanafilla 1:1-2.....1 Në fillim Perëndia krijoi qiejt dhe tokën. 2 dhe Fryma e Perëndisë fluturonte mbi sipërfaqen e ujërave.

Jobi 26:13*.....Me Frymën e tij ka zbukuruar qiejt,

Jobi 33:4*.....Fryma e Perëndisë më ka krijuar dhe fryma e të Plotfuqishmit më jep jetë.

Psalmet 104:30.....Ti dërgon frymën tënde dhe ata krijohen, kështu ti ripërtërin faqen e dheut.

Maide 5:110, 116 & 118*.....kur të fuqizova me shpirtin e shenjtë (Xhibrilin) 116 Ti je më i dijsmi i të fshehtave!" 118 Ti je i gjithëfuqishmi, i urti.

53.

A janë "Fryma e Shenjtë" dhe engjëlli Gabriel i njëjti?

Bibla Jo / Po Kurani

Luka 1:11-35*.....13 Por engjëlli i tha: "Mos u tremb, Zakaria, sepse lutja jote u plotësua dhe gruaja jote Elizabeta do të lindë një djalë, të cilit do t'ia vësh emrin Gjon. 15 i përplotë me Frymën e Shenjtë që në barkun e s'emës. 19 Dhe engjëlli, duke iu përgjigjur, i tha: "Unë jam Gabrieli që rri në prani të Perëndisë, dhe më kanë dërguar që të flas me ty dhe të të njoftoj këto lajme të mira.

Gjoni 4:24.....Perëndia është Frymë...

Bakara 2:87 & 98*.....87 Isait, birit të Merjemës i dhamë argumente (mrekulli) dhe e fuqizua me (Xhibrilin) shpirtin e shenjtë. 98 Kush është armik i All-llahut, i engjëjve të Tij, i të dërguarve të Tij, i Xhibrilit dhe i Mikailit (ai është mosbesimtarë), All-llahu është pa dyshim armik i mosbesimtarëve.

Shënim: Në Islam, Fryma e Shenjtë përgjithësisht përcaktohet si të qënurit engjëlli Gabriel.

54.*

A është blasfemia ndaj "Frymës së Shenjtë" i vetmi mëkat i pafalshëm?

Bibla Po / Jo Kurani

Mateu 12:31-32*.....31 Prandaj unë po ju them: Çdo mëkat dhe blasfemi do t'u falet njerëzve; por blasfemia kundër Frymës nuk do t'u falet atyre. 32 Dhe kushdo që flet kundër Birit të njeriut do të falet; por ai që flet kundër Frymës së Shenjtë nuk do të falet as në këtë botë as në atë të ardhme''.

Nisa 4:48, 116 & 168*.....48 S'ka dyshim se All-llahu nuk falë (mëkatin) t'i përshkruhet Atij shok (idhujtarinë), 116 Është e vërtetë se All-llahu nuk falë (mëkatin) t'i bëhet Atij shok, pos këtij (mëkati), 168 Aa që nuk besuan dhe bënë zullum, All-llahu as nuk ka për t'i falur as nuk ka për t'i drejtuar në rrugë ,

55.

A përqendrohen Librat e Shenjtë te gjërat e Frymës?

Bibla Po / Jo Kurani

Romakeve 1:11.....sepse unë dëshiroj fort t'ju shoh për t'ju komunikuar ndonjë dhunëti frymëror, që të fortësoheni.

Romakeve 8:9.....Nëse Fryma e Perëndisë banon në ju, ju nuk jeni më në mish, por në Frymë. Por në qoftë se ndokush nuk ka Frymën e Krishtit, ai nuk i përket atij.

1 Korintasve 2:13-16*.....13 Për këto edhe flasim, por jo me fjalë të mësuara nga dituria njerëzore, por të mësuara nga Fryma e Shenjtë, duke i krahasuar gjëra frymërore me fjalë frymërore. 15 Por njeriu që është frymëror gjykon çdo gjë dhe vetë nuk është i gjykuar nga asnjëri.

Juda 18-19*.....18 Ata ju thoshnin që në kohën e fundit do të ketë tallës që do të ecin sipas pasioneve të tyre të paudhësisë. 19 Këta janë ata që shkaktojnë përçarjet, njerëz mishor, që s'kanë Frymën.

Isra 17:85*.....Të pyesin ty për shpirtin; Thuaj: "shpirti është çështje që i përket vetëm Zoti tim, e juve ju është dhënë fort pak dije".

56.*

A banon "Fryma e Shenjtë" e Perëndisë tek besimtarët dhe a u jep atyre dhunti shpirtërore?

Bibla Po / Jo Kurani

Gjoni 20:21-23.....21 Pastaj Jezusi u tha atyre përsëri: "Paqja me ju! Sikurse më ka dërguar mua Ati, ashtu unë po ju dërgoj ju". 22 Dhe, si tha këto fjalë, hukati mbi ta dhe tha: "Merrni Frymën e Shenjtë!"

Veprat 1:8.... Ju do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju dhe do të bëheni dëshmitarët

1 Korintasve 12:1, 4-11 & 13*.....1 Edhe për sa u përket dhuntive frymërore, o vëllezër, nuk dua të jeni të paditur. 7 Dhe secilit i jepet shfaqja e Frymës për dobinë e përbashkët. 13 dhe të gjithë e kemi jemi uijturi në të njëjtin Frymë.

Shënim: Kura'ni nuk tregon për dhuntitë frymërore apo për mbushjen me Frymën e Shenjtë.

57.

A mundët që dhuntive frymërore të deportohen nga një besimtari te tjetri me venien e duarve?

Bibla Po / Jo Kurani

1 Timoteut 4:14-16*.....14 Mos e lër pas dore dhuntinë që është në ty, e cila të është dhënë me anë profecie, me vënien e duarve nga ana e pleqësisë.

2 Timoteut 1:6.....Për këtë arsye po të kujtoj ta zgjosh dhuntinë e Perëndisë që është në ty me anë të vënies së duarve të mia.

Hebrenjte 6:1.....Prandaj, duke e lënë fjalën e fillimit të Krishtit, le të synojmë përkryerjen, pa hedhur përsëri themel pendimi nga vepra të vdekura dhe nga besimi te Perëndia,

Shënim: Në Kura'n nuk tregohet për venien e duarve për transmetimin e dhuntive frymërore. Krahaso: Romakeve 1:11, 2 Selanikasve 2:8 & 1 Timoteut 4:14-16.

58.

A u jep Perëndia ndjekësve të Jezusit aftësinë për të bërë të njëjtat mrekulli që Jezusi bëri nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë që banon në ta?

Bibla Po / Jo Kurani

Gjoni 14:12*.....Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them: kush beson në mua do të bëjë edhe ai veprat që bëj unë; madje do të bëjë edhe më të mëdha se këto, sepse unë po shkoj tek Ati.

Luka 10:17*....Dhe të shtatëdhjetët u kthyen me gëzim dhe thanë: ''Zot, edhe demonët na nënshtrohen në emrin tënd''.

Veprat 6:8.....Dhe Stefani, plot besim dhe fuqi, bënte mrekulli dhe shenja të mëdha nëpër popull.

Veprat 8:6.....Dhe turmat, me një mendje të vetme, dëgjonin me vëmendje gjërat që thoshte Filipi, duke dëgjuar dhe duke parë mrekullitë që ai bënte.

Shënim: Nuk gjenden shënime në Kura'n për dike pas Krishtit që ka bërë mrekulli të dukshme.

59.

A u jep Perëndia disa besimtarëve dhuntinë e të folurit në një gjuhë të panjohur nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë?

Bibla Po / Jo Kurani

1 Korintasve 14:2, 5*.....2 sepse ai që flet një gjuhë tjetër nuk u flet njerëzve, por Perëndisë; sepse askush nuk e kupton, por ai në frymë flet mistere. 5 Unë dua që të gjithë ju të flisnit gjuhëra...

Romakeve 8:26-27*.....26 Kështu, pra, edhe Fryma na ndihmon në dobësitë tona, sepse ne nuk dimë çfarë të kërkojmë në lutjet tona, sikurse duhet; por vetë Fryma ndërhyr për ne me psherëtima të patregueshme. 27 Dhe ai që heton zemrat e di cila është mendja e Frymës, sepse ai ndërhyr për shenjtoret, sipas Perëndisë.

Shënim: Në Kura'n nuk ka vargje mbi të folurit në gjuhëra.

60.*

A ka një dallim të prerë mes engjëjve (melek) si shërbëtorë të Perëndisë dhe demonëve (xhin) si shërbëtorë të djallit?

Bibla Po / Jo Kurani

Mateu 25:41*.....Pastaj ai do t'u thotë edhe atyre që do të jenë në të majtë: "Largohuni nga unë, të mallkuar, në zjarr të përjetshëm, të përgatitur për djallin dhe engjëjt e tij.

Zbulesa 12:9*.....Kështu dragoi i madh, gjarpëri i lashtë, që është quajtur djall, edhe Satan, që mashtron gjithë dheun, u hodh mbi tokë; me të u hodhën edhe engjëjt e tij.

Jinn 72:1-16*.....1 Thuaj: "Mua më shpalllet se një grup i vogël nga xhinët i vuri veshin dhe dëgjoi (Kur'anin) dhe (kur u kthyen te të vetët) thanë: "Ne kemi dëgjuar një Kur'an që mahnit, 2 që udhëzon në të vërtetën, andaj ne i besuam atij dhe Zotit tonë, kurrsesi nuk do t'ia shoqërojmë më akë" 11 Është e vërtetë se prej nesh ka të mirë, por ka edhe që nuk janë aq të mirë, sepse ne kemi qenë në drejtime të ndryshme.

61.

A do të ishte e mundur që Satani të pendohej e të bëhej i mirë?

Bible Jo / Jo Qur'an

Zbulesa 12:9*.....Kështu dragoi i madh, gjarpëri i lashtë, që është quajtur djall, edhe Satan, që mashtron gjithë dheun, u hodh mbi tokë; me të u hodhën edhe engjëjt e tij.

Bakara 2:208*.....O ju që besuat, hyni në islamizmin e tërësishëm (Përqafohi fenë islame në tërësi), e mos ndiqni rrugën e djallit, sepse ai është armik i juaji i hapët.

Zukhruf 43:36-39.....36 Kush mbyll sytë para këshillave të Zotit, atij ia shoqërojmë një djall që nuk i ndahet kurrë. 39 Dhe sot, për shkak se ishit zullumqarë, shoqërimi juaj nuk do t'ju bëjë dobi në vuajtjet tuaja.

62.

A do të ishte e mundur që disa demonë të pendoheshin e të bëheshin të mirë? (Jinn)

Bibla Jo / Po Kurani

Juda 6-7*.....6 Ai i ruajti me pranga të përjetshme në errësirë për gjyqin e ditës së madhe, edhe engjëjt që nuk e ruajtën gjendjen e tyre të parë, po e lanë banimin e tyre, 7 janë vënë përpara si shembull, duke pësuar ndëshkimin e një zjarri të përjetshëm;

Jinn 72:1, 11, 13 & 14*.....1 Thuaj: "Mua më shpallet se një grup i vogël nga xhinët i vuri veshin dhe dëgjoi (Kur'anin) dhe (kur u kthyen te të vetët) thanë: "Ne kemi dëgjuar një Kur'an që mahnit, 11 Është e vërtetë se prej nesh ka të mirë, por ka edhe që nuk janë aq të mirë, sepse ne kemi qenë në drejtime të ndryshme. 13 Dhe ne, sapo e dëgjuam udhëzimin (Kur'anin), i besuam atij, e kush e beson Zotit të vet, ai nuk i frikësohet ndonjë dënimi e as ndonjë padrejtësie. 14 Është e vërtetë se prej nesh ka besimtarë (myslimanë) dhe prej nesh ka që janë jashtë rrugës (jobesimtarë), e kush e pranoi islam, të tillët mësynë rrugën e shpëtimit.

Shënim: Krahaso: Mateu 25:41, 2 Pjetri 2:4, Zbulesa 12:9 & Ahkaf 46:29-31.

63.*

A ka vargje në Bibël për dëbimin e demonëve jashtë njerëzve?

Bibla Po / Jo Kurani

Mateu 9:33.....Dhe, mbasi e dëboi demonin, memeci foli dhe turmat u çuditën dhe thanë: "'Nuk është parë kurrë një gjë e tillë në Izrael''.

Mateu 17:18.....Atëherë Jezusi e qortoi demonin dhe ky doli nga djali; dhe që nga ai çast djali u shërua.

Marku 1:25-26*.....25 Por Jezusi e qortoi duke thënë: "'Hesht dhe dil prej tij!'''. 26 Dhe fryma e ndyrë, mbasi e sfiliti, dhe duke lëshuar një britmë të madhe doli prej tij.

Luka 4:35.....Por Jezusi e qortoi duke thënë: "'Hesht dhe dil prej tij!'''. Dhe demoni, pasi e përplasi përpara tyre, doli prej tij pa i bërë asgjë të keqe.

Shënim: Nuk ka vargje në Kura'n mbi dëbimin e demoneve nga njerëzit, por ka 89 vargje në Bibël rreth dëbimit të demoneve.

64.

A përshkruhet fuqia mashtruese e Satanit si e dobët dhe e pafrytshme?

Bibla Jo / Po Kurani

Luka 4:6*.....Dhe djalli i tha: "'Unë do të të jap gjithë pushtetin e këtyre mbretërive dhe lavdinë e tyre, sepse m'u dha mua në dorë dhe unë ia jap kujt të dua.

2 Korintasve 4:3-4.....3 Dhe, në goftë se ungjilli ynë është ende i mbuluar me vel, ai është i mbuluar për ata që humbin, 4 të cilëve perëndia i këtij shekulli ua verboi mendjet

Nisâ 4:76*.....Luftoni pra miqtë e djallit, s'ka dyshim se intriga e është e dobët.

İbrahim 14:22.....e unë ju pata premtuadhe, qe, nuk zbatova premtimin ndaj jush.

Nahl 16:98.... Kur të lexosh Kur'anin kërko mbrojtjen e All-llahut prej djallit të mallkuar.

Shu'arâ 26:210-211*.....210 Atë (Kur'anin) nuk e sollën djajt (si fallin falltorëve). 211 Atyre as nuk u takon e as që kanë mundësi.

65.*

A quhet Satani "princi" ose "sunduesi" i kësaj bote?

Bibla Po / Jo Kurani

Luka 4:6.....Dhe djalli i tha: "Unë do të të jap gjithë pushtetin e këtyre mbretërive dhe lavdinë e tyre, sepse m'u dha mua në dorë dhe unë ia jap kujt të dua.

Gjoni 12:31.....Tani është gjykimi i kësaj bote; tani do të hidhet jashtë princi i kësaj bote!

Gjoni 14:30*.....Nuk do të flas më gjatë me ju, sepse po vjen princi i kësaj bote dhe ai nuk ka asgjë në mua;

2 Korintasve 4:3-4*.....3 Dhe, në qoftë se ungjilli ynë është ende i mbuluar me vel, ai është i mbuluar për ata që humbin, 4 të cilëve perëndia i këtij shekulli ua verboi mendjet

Nisa 4:76.....s'ka dyshim se intriga e është e dobët.

Shuara 26:210-211.....210 Atë (Kur'anin) nuk e sollën djajt (si fallin falltorëve). 211 Atyre as nuk u takon e as që kanë mundësi.

Shënim: Krahaso: Gj. 16:11, 2 Kor. 11:14, Ef. 6:11-12.

Krishti dhe Muhamedi

66.*

A pranohet se Krishti u lind nga një virgjëreshë?

Bibla Po / Po Kurani

Isaia 7:14*.....Prandaj vet Zoti do t'ju japë një shenjë: Ja, e virgjëra do të mbetet me barrë dhe do të lindë një fëmijë të cilin do ta quajë Emanuel.

Mateu 1:18*.....Tani lindja e Jezu Krishtit ndodhi në këtë mënyrë: Maria, nëna e tij, i ishte premtuar Jozefit, por para se të fillonin të rrinin bashkë, mbeti shtatzënë nga Frymën e Shenjtë.

Meryem 19:16-21*.....16 E, përmendju në këtë libër (tregimin për) Merjemen kur ajo u largua prej familjes së saj në një vend në lindje. 21 Ai (Xhibrili) tha: "Ja, kështu ka thënë Zoti yt; ajo për Mua është lehtë, e për ta bërë atë (djalin e krijuar pa babë) argument për njerëzit e edhe mëshirë nga ana e Jonë.

Enbiya 21:91*.....(Ne e frymëzuam atë me shpirt (barrë) nga ana Jonë dhe atë dhe të birin e saj; bëmë mrekulli për njerëzit.

67.*

A pranohet se Krishti ishte pa mëkat?

Bibla Po / Po Kurani

Marku 1:24.....Jezus... Unë e di kush je: I Shenjti i Perëndisë''.

Gjoni 7:18.....kurse ai që kërkon lavdinë e atij që e ka dërguar është i vërtetë, dhe në të nuk ka padrejtësi.

Gjoni 8:46*.....Cili nga ju më bind për mëkat? Nëse flas të vërtetën, përse nuk më besoni?

2 Korintasve 5:21.....Sepse ai bëri të jetë mëkat për ne ai që nuk njihte mëkat, që ne të bëhemi drejtësia e Perëndisë në të.

1 Pjetri 2:21-22.....21 Krishti 22 ''Ai nuk bëri asnjë mëkat dhe nuk u gjet asnjë mashtrim në gojë të tij''.

1 Gjoni 3:5*.....Dhe ju e dini se ai u shfaq për të hequr mëkatet tona; dhe në të nuk ka mëkat.

Bakara 2:253*.....Isait, birit të Merjemës i dhamë argumente dhe e përfocua me shpirtin e shenjtë

Meryem 19:19*.....Ai (Xhibrili) tha: "Unë jam vetëm i dërguar (melek) i Zotit tënd për të dhuruar ty një djalë të pastër (pejgamber)".

68.*

A pranohet se Krishti zotëronte urtësi dhe dituri të mbinatyrshme?

Bibla Po / Po Kurani

Mateu 9:4.....Por Jezusi, duke njohur mendimet e tyre, tha: ''Pse mendoni gjëra të mbrapështa në zemrat tuaja?

Gjoni 16:30*.....Tani ne njohim se ti di gjithçka dhe s'ke nevojë që ndokush të të pyesë;

Al-i İmran 3:45-48*.....45 All-llahu të përgëzon me fjalën e vet (me lindjen e një fëmije si rezultat i fjalës së Zotit). 48 Ai (All-llahu) ia mëson atij librin (besimin), urtësinë, Tevratin dhe Inxhilin.

Zuhruf 43:63*.....Isai... "Erdha te ju me pejgamberllëk dhe erfha t'ju sqaroj atë pjesë që e kundërshtonit, pra kini frikë All-llahun dhe më respektoni mua!

69.*

A pranohet se Krishti zotëronte fuqi të mbinatyrshme për të bërë mrekulli dhe për t'u kthyer jetën të vdekurve?

Bibla Po / Po Kurani

Marku 1:40-45.....40 lebroz... ''Po të duash, ti mund të më pastrosh''. 41 ''Po, e dua, qofsh pastruar!''.

Marku 6:47-52.....49 Por ata, kur e panë që po ecte mbi det, menduan se ishte një fantazmë dhe filluan të bërtasin,

Gjoni 11:14-44*.....14 Atëherë Jezusi u tha atyre haptas: ''Llazari ka vdekur. 25 Jezusi i tha: ''Unë jam ringjallja dhe jeta; 43 Dhe, mbasi tha këto, thirri me zë të lartë: ''Llazar, eja jashtë!'''. 44 Atëherë i vdekuri doli,

Al-i İmran 3:45-50*.....45 All-llahu të përgëzon me fjalën e vet (me lindjen e një fëmije si rezultat i fjalës së Zotit).

Maide 5:110*.....e urtësinë Tevratin e Inxhilin, kur melejen Time formove nga balta si formë shpeze e i fryve asaj dhe me urdhërin Tim u bë shpezë...

Shënim: Gjendën 37 mrekulli nga Jezusi ne Injil / Ungjijt.

70.*

A pranohet se Krishti ka të drejtë të kërkojë besim dhe bindje nga të gjithë njerëzit?

Bibla Po / Po Kurani

Mateu 23:10*....sepse vetëm një është udhëheqësi juaj: Krishti.

Gjoni 14:15 & 21-24*.....15 ''Nëse më doni, zbatoni urdhërimet e mia. 21 Kush ka urdhërimet e mia dhe i zbaton, është ai që më do; 23 ''Nëse ndokush më do, do ta zbatojë fjalën time; 24 Kush nuk më do, nuk i zbaton fjalët e mia;

Al-i İmran 3:50 & 55*.....50 kam ardhur me argument nga Zoti juaj, pra kinie frikë All-llahun dhe më dëgjoni mua. 55 E ata që të besuan ty, do t'i ngrisë lart mbi ata që nuk besuan deri në ditën e kijametit, **Zuhruf 43:61**..... (Isai) është parashenjë e momentit (e kijametit), pra kurrresi mos dyshoni në të (në katastrofë) dhe eni pas meje kjo është rruqë e drejtë.

71.*

A pranohet se Jezus Krishti identifikohet si Mesia (i Vajosuri)?

Bibla Po / Po Kurani

Mateu 26:63-64.....63 për Perëndinë e gjallë të na thuash në se ti je Krishti, Biri i

Perëndisë''. 64. Jezusi i tha: ''Ti po thua!

Gjoni 1:41*.....Simonin, dhe i tha: ''E gjetëm Mesian që përkthyer do të thotë: "Krishti"'';

Gjoni 4:25-26*.....25 Gruaja i tha: ''Unë e di se do të vijë Mesia, që e quajnë Krisht; kur të ketë ardhur, ai do të na kumtojë çdo gjë''. 26 Jezusi i tha: ''Unë jam, ai që po të flet!''.

Al-i İmran 3:45*.....All-llahu të përgëzon me fjalën e vet (me lindjen e një fëmije si rezultat i fjalës së Zotit).

Nisa 4:171.....Mesihu Isa, bir i merjemes, ishte vetëm i dërguar i All-llahut. Ishte fjalë e Tij (bëhu) që ia drejtoi Merjemes dhe ishte frymë (shpirt) nga Ai.

Shënim: Fjalët "Mesia" apo "Krishti" janë përmendur 558 herë në Dhjatën e Re dhe fjala "Mesia" është përdorur 10 herë në Kura'n duke iu referuar Krishti.

72.*

A pranohet se Krishti është quajtur Fjala e Perëndisë? (Logos / Kalimullâh)

Bibla Po / Po Kurani

Gjoni 1:1 & 14*.....1 Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi. 14 Dhe Fjala u bë mish dhe banoi ndër ne;

Zbulesa 19:13-16*.....13 Dhe ishte i veshur me një rrobe të ngjyer në gjak; dhe emri i tij quhet: "Fjala e Perëndisë". 16 Dhe mbi rroben e vet dhe mbi kofshën ishte shkruar një emër: MBRETI I MBRETËRVE dhe ZOTI I ZOTËRVE.

Al-i İmran 3:39*....."All-llahu të përgëzon ty me Jahjanë, që do të vërtetojë fjalën (Isain) e ardhur nga All-llahu, e që do të jetë prijës i matur dhe peygamber nga të dalluarit!"

Al-i İmran 3:45*.....All-llahu të përgëzon me fjalën e vet (me lindjen e një fëmije si rezultat i fjalës së Zotit).

73.*

A pranohet se Krishti egzistonte si Fjala e Perëndisë para se të lindej?

Bibla Po / Jo Kurani

Isaia 9:6*..... aaa see Sepse na ka lindur një fëmijë, një djalë na është dhënë. Mbi supet e tij do të mbështetet perandoria dhe do të quhet... Perëndi i fuqishëm, Atë i përjetshëm,

Micah 5:2*.....Por ti, o Betlem Efratah, megjithëse je i vogël midis mijërave të Judës, nga ti do të dalë për mua ai që do të jetë sundues në Izrael, origjinat e të cilit janë nga kohërat e lashta, nga ditët e përjetësisë.

Gjoni 8:58.....Jezusi u tha atyre: "'Në të vërtetë, në të vërtetë unë po ju them: para se të kishte lindur Abrahami, unë jam''.

Hebrenjte 13:8.....Krishti është i njëjtë dje, sot e përjetë.

Al-i İmran 3:59*.....Vërtet, qështja e Isait (të lindur pa baba) te All-llahu është sikurse qështja e Ademit. Atë e krijoi Ai nga dheu, e pastaj atij i tha "Bëhu!" ai u bë.

74.*

A pranohet se Fjala e përjetshme e Perëndisë mori trup njerëzor me mishërimin e Jezus Krishtit? (Kenosis or Hülul)

Bibla Po / Jo Kurani

Mateu 1:18-24.....23 'Ja, virgjëresha do të mbetet shtatzënë dhe do të lindë një djalë, të cilit do t'i venë emrin Emanuel, që do të thotë: "Zoti me ne"'.

Gjoni 1:1 & 14.....1 Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi. 14 Dhe Fjala u bë mish dhe banoi ndër ne;

Filipianeve 2:5-8*.....5 Jezu Krishtin, 6 i cili, edhe pse ishte në trajtë Perëndie, 7 por e zbrazi veten e tij, duke marrë trajtë shërbëtori, e u bë i ngjashëm me njerëzit;

Maide 5:17*.....E mohuan (e bënë kufr) të vërtetën ata që thanë se: "Zot është ai, Mesihu bir i Merjemes" Thuaju:

75.*

A pranohet se Krishti është "Hyjnor" ose Perëndia në mish?

Bibla Po / Jo Kurani

Gjoni 1:1 & 14.....1 Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi. 14 Dhe Fjala u bë mish dhe banoi ndër ne;

Gjoni 5:17-18.....18 por edhe se thoshte se Perëndia ishte ati i vet, duke e barazuar veten me Perëndinë.

Gjoni 10:25-33.....25 Jezusi... veprat që bëj në emër të Atit tim, janë ato që dëshmojnë për mua. 30 Unë dhe Ati jemi një''.

Gjoni 20:28-29*.....28 Atëherë Thomai u përgjigj dhe i tha: ''Zoti im dhe Perëndia im!''.

29 Jezusi i tha: ''Sepse më ke parë, Thoma, ti ke besuar; lum ata që nuk kanë parë dhe kanë besuar!''.

Kolosianeve 2:8-9*.....8 Krishtit, 9 want in Hom bly die hele volheid van wat God is gesamentlik

Maide 5:17, 72, 75, 116 & 118*.....17 E mohuan (e bënë kufr) të vërtetën ata që thanë se: "Zot është ai, Mesihu bir i Merjemes" Thuaju:

Zuhruf 43:57-59*.....59 Ai (Isai) ka qenë vetëm një rob, të cilin e bëmë peygamber dhe e bëmë shembull të jashtëzakonshëm si përvojë për beni israilët.

Shënim: Bibla përcakton Jezusi si "Perëndi" 367 herë.

76.*

A pranohet se Krishti krijoi botën?

Bibla Po / Jo Kurani

Kolosianeve 1:13-20*.....13 Ai na nxori nga pushteti i errësirës dhe na çoi në mbretërinë e Birit të tij të dashur, 15 Ai është shëmbëllesa e Perëndisë së padukshëm, i parëlinduri i çdo krijese, 16 sepse në të u krijuan të gjitha gjërat,

Maide 5:75, 116 & 118*.....75 Mesihu, bir i Merjemes, nuk është tjetër, vetëm se i dërguar; 116 Dhe kur All-llahu tha: "O Isa, bir i Merjemes, a ti njerëzve u the: "Më besoni mua dhe nënës time dy zota pos All-llahut!?" (Isai) Tha: "Larg asaj të mete je Ti (o Zoti im). Nuk më takon mua ta them atë që s'është e vërtetë."

77.*

A pranohet se Krishti është i vetmi ndërmjetës mes Perëndisë dhe njeriut?

Bibla Po / Jo Kurani

Gjoni 14:6*.....Jezusi i tha: "Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje.

Veprat 4:12*.....Dhe në asnjë tjetër nuk ka shpëtim, sepse nuk ka asnjë emër tjetër nën qiell që u është dhënë njerëzve dhe me anë të të cilit duhet të shpëtohem!

1 Timoteut 2:5-6*.....Në fakt një është Perëndia, dhe një i vetëm është ndërmjetësi midis Perëndisë dhe njerëzve: Krishti Jezus njeri, i cili e dha veten si çmim për të gjithë,

Yunus 10:3*.....Ndërmjetësues nuk do të ketë vetëm poqese lejon Ai.

Zümer 39:44.....Thuaj: "I tërë shefaati (ndërmjetësimi) i takon vetëm All-llahut,

78.*

A pranohet se Krishti është Biri i Perëndisë?

Bibla Po / Jo Kurani

Mateu 16:16.....Dhe Simon Pjetri duke u përgjigjur tha: "Ti je Krishti, Biri i Perëndisë të gjallë".

Marku 14:61-62.....61 Përsëri kryepriifti e pyeti dhe i tha: "A je ti Krishti, Biri i të Bekuarit?". 62 Dhe Jezusi tha: "Unë jam.

Luka 1:32 & 35*.....32 Ai do të jetë i madh dhe do të quhet Biri i Shumë të Lartit; 35 Dhe engjëlli duke u përgjigjur, i tha: "Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ty dhe pushteti i Shumë të Lartit do të të mbulojë me hijen e vet; prandaj i shenjtë që do të lindë prej teje do të quhet Bir i Perëndisë.

Tevbe 9:30-31*.....30 E jehuditë thanë: Uzejri është djali i All-llahut, e të kristerët thanë: Mesihu është djalë i All-llahut. All-llahu i vraftë, si largohen (nga e vërteta)! 31 që nuk ka të adhuroar tjetër pos tij.

Shënim: Gjendën 92 vargje në Bibël që e përcaktojnë Jezusin si "Biri i Perëndisë", por krahaso: En'am 6:101, Furkan 25:2, Zuhruf 43:81 & Jinn 72:3.

79.

Kur në Librat e Shenjtë termi "bir i Perëndisë" është përdorur, a është kjo me kuptimin të një bir fizikë duke u lindur nga një bashkim seksual?

Bibla Jo / Po Kurani

Luka 1:26-35*.....27 dhe emri i virgjërshës ishte Maria. 35 Dhe engjëlli duke u përgjigjur, i tha: "Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ty dhe pushteti i Shumë të Lartit do të të mbulojë me hijen e vet; prandaj i shenjtë që do të lindë prej teje do të quhet Bir i Perëndisë.

1 Gjoni 5:20*.....në Birin e tij Jezu Krisht; ky është i vërteti Perëndi dhe jeta e përjetshme.

En'am 6:101*.....e si do të ketë Ai fëmijë kur nuk pati bashkëshorte?

Jinn 72:3*.....Dhe se latësua e madhëruar e Zotit tonë, nuk është që ka as grua, as fëmijë.

80.

A u adhuroa Krishti nga njerëzit dhe a e pranoi Ai adhurimin e njerëzve si të vlefshëm?

Bibla Po / Jo Kurani

Mateu 28:9-10*.....9 Dhe, ndërsa po shkonin për t'u thënë dishepujve, ja Jezusi u doli përpara dhe tha: "Tungjatjeta!". Atëherë ato u afruan, i rrokën këmbët dhe e adhuruan.

Gjoni 9:35-38.....35 Jezusi... "A beson ti në Birin e Perëndisë?". 38 Atëherë ai tha: "Unë besoj, o Zot!"; dhe e adhuroi.

Gjoni 20:28-29*.....28 Atëherë Thomai u përgjigj dhe i tha: "Zoti im dhe Perëndia im!". 29 lum ata që nuk kanë parë dhe kanë besuar!".

Filipianeve 2:10-11.....10 që në emër të Jezusit të përkulet çdo gju i krijesave (ose gjërave) qiellore, tokësore dhe nëntokësore, 11 dhe çdo gjuhë të rrëfejë se Jezu Krishti është Zot, për lavdi të Perëndisë Atë.

Maide 5:116 & 118*.....Dhe kur All-llahu tha: "O Isa, bir i Merjemes, a ti njerëzve u the: "Më besoni mua dhe nënës time dy zota pos All-llahut!?" (Isai) Tha: "Larg asaj të mete je Ti (o Zoti im). Nuk më takon mua ta them atë që s'është e vërtetë.

81.*

A pranohet se Krishti mund të falë mëkatet e njerëzve?

Bibla Po / Jo Kurani

Marku 2:5-7 & 10-11*.....5 Jezusi, kur pa besimin e tyre, i tha të paralizuarit: "'O bir, mëkatet e tua të janë falur!'. 7 "'Pse vallë ky po flet blasfemi. Kush mund të falë mëkatet, veç Perëndisë vetë?'. 10 Dhe tani, që ta dini se Biri i njeriut ka pushtet të falë mëkatet mbi dhe, 11 unë po të them (i tha të paralizuarit): Çohu, merre vigun tënd dhe shko në shtëpinë tënde!'''.

Luka 5:20.....Toe Yeshua hulle verroue sien, sê Hy vir die verlamde man: "Man, jou sondes is vir jou vergewe."

Veprat 10:43*.....Për të bëjnë dëshmi të gjithë profetët, që kushdo që beson në të merr faljen e mëkateve me anë të emrit të tij'''.

Veprat 13:38.....Le ta dini, pra, o vëllezër, se nëpërmjet tij ju është shpallur falja e mëkateve,

Al-i İmran 3:135*.....e kushi i falë mëkatet përveç All-llahut?

Maide 5:75*.....Mesihu, bir i Merjemes, nuk është tjetër, vetëm se i dërguar;

82.

A pranohet se Krishti mban çelësat e vdekjes dhe ferrit?

Bibla Po / Jo Kurani

Luka 12:5.....druani nga ai që, pasi ka vrarë, ka pushtet të të hedhë në Gehena; po, po ju them, nga ai të keni frikë.

Zbulesa 1:1-18*.....1 Zbulesa e Jezu Krishtit, që Perëndia ia dha për t'u treguar shërbëtorëve 8 "'Unë jam Alfa dhe Omega, fillimi dhe mbarimi'', thotë Zoti "'që është dhe që ishte dhe që vjen, i Plotfuqishmi''. 18 dhe i gjalli; isha i vdekur, por ja, jam i gjallë në shekuj të shekujve, amen; dhe unë i kam çelësat e vdekjes e të Hadesit.

Zuhruf 43:57 & 59*.....57 biri i Merjemes... 59 Ai (Isai) ka qenë vetëm një rob, të cilin e bëmë pejgamber dhe e bëmë shembull

83.*

A pranohet se Krishti është "Shpëtimtari" i botës?

Bibla Po / Jo Kurani

Isaia 43:11-13.....Unë, unë jam Zoti dhe përveç meje nuk ka Shpëtimtar tjetër.

Luka 2:11.....sepse sot në qytetin e Davidit lindi për ju një Shpëtimtar, që është Krishti, Zoti.

Gjoni 4:42*.....e kemi dëgjuar dhe dimë se ai është me të vërtetë Krishti, Shpëtimtari i botës''.

Titit 1:4.....hir, mëshirë dhe paqe prej Perëndisë, Atit, dhe prej Zotit Jezu Krisht, Shpëtimtarit tonë.

Titit 3:4-6.....4 Po kur u shfaq mirësia e Perëndisë, Shpëtimtarit tonë, dhe dashuria e tij për njerëzit, 6 të cilën e derdhi me mbushëlli mbi ne, me anë të Jezu Krishtit, shpëtimtarit tonë,

1 Gjoni 4:14*.....Dhe ne pamë dhe dëshmojmë se Ati e dërgoi Birin për të qënë Shpëtimtar i botës.

Nisa 4:171*....Mesihu Isa, bir i merjemes, ishte vetëm i dërguar i All-llahut.

84.*

A pranohet se besimi në Krishtin si Shpëtimtar dhe Zot është mënyra e vetme për të marrë jetën e përjetshme?

Bibla Po / Jo Kurani

Gjoni 3:16 & 36.....36 Kush beson në Birin ka jetë të përjetshme, kurse kush nuk i bindet Birit nuk do të shohë jetë, por zemërimi i Perëndisë qëndron mbi të''.

Gjoni 14:6*.....Jezusi i tha: ''Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje.

Veprat 4:10-12*.....10 bë në emër të Jezu Krishtit Nazareas, 12 Dhe në asnjë tjetër nuk ka shpëtim, sepse nuk ka asnjë emër tjetër nën qiell që u është dhënë njerëzve dhe me anë të të cilit duhet të shpëtohem''.

Al-i İmran 3:19 & 85*.....19 Pa dyshim feja te All-llahu është Islami. 85 E, kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kurrsesi nuk do ti pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpruarit.

Shënim: Ka mbi 200 vargje në Bibël që e përcaktojnë Jezusin si Shpëtimtari i botës.

85.*

A pranohet se gjaku i Krishtit u derdh si shpengim me flijim për mëkatet e botës? (Shpengim / Fidje)

Bibla Po / Jo Kurani

Isaia 53:5-12....5 Por ai u tejshpua për shkak të shkeljeve tona, u shtyp për paudhësitë tona; ndëshkimi për të cilin kemi paqen është mbi të, dhe për shkak të vurratave të tij ne jemi shëruar. 6 dhe Zoti bëri që të bjerë mbi të paudhësia e ne të gjithëve.

Gjoni 1:29*.....Të nesërmen, Gjoni e pa Jezusin që po vinte drejt tij dhe tha: "Ja, Qengji i Perëndisë, që heq mëkatin e botës!

1 Korintasve 15:3-4.....3 se Krishti vdiq për mëkatet tona sipas Shkrimeve,

En'am 6:164*.....Askush nuk do të bartë barrën e tjetrit.

İsra 17:15.....e askushnuk do ta batë barrën e tjetrit.

Nejm 53:38*.....(Në të cilat shkruan) Se askush nuk e bartë barrën e tjetrit

86.

Në Librat e Shenjtë, a shpallet nga profetët se Mesia (Jezusi) do të vdiste?

Bibla Po / Po Kurani

Psalmets 16:10.....sepse ti nuk do ta lësh shpirtin tim në Sheol

Isaia 53:1-12*.....11 do të bëjë të drejtë shumë veta, sepse do të marrë përsipër paudhësitë e tyre. 12 sepse e ka përkushtuar jetën e tij deri në vdekje dhe u përfshi midis keqbërësve; ai ka mbajtur mëkatin e shumë vetave dhe ka ndërhyrë në favor të shkelësve.

Danieli 9:26*.....Mbas gjashtëdhjetë e dy javëve Mesia do të vritet dhe askush nuk do të jetë me të.

Al-i İmran 3:55*.....(Përkujto, o i dërguar) Kur All-llahu tha: 'O Isa, Unë po të marr ty, po të ngris te Unë, po të shpëtoj prej sherrit të atyre që nuk besuan. E ata që të besuan ty, do t'i ngrisë lart mbi ata që nuk besuan deri në ditën e kijametit,

Meryem 19:30 & 33*.....ditën kur të vdes dhe ditën kur të dal (prej varrit) i gjallë!"

87.

A e paratha Jezusi vetë se do të vritej nga judenjtë?

Bibla Po / Jo Kurani

Mateu 16:21-23*.....21 Që nga ai çast Jezusi filloi t'u sqarojë dishepujve të vet se i duhej të shkonte në Jeruzalem, të vuante shumë për shkak të pleqve, të krerëve të priftërinjve dhe të skribëve, se do të vritej dhe do të ringjallej të tretën ditë. 22 Atëherë Pjetri e mori mënjanë dhe nisi ta qortojë duke thënë: ''O Zot, të shpëtoftë Perëndia; kjo nuk do të të ndodhë kurrë''. 23 Por ai u kthye dhe i tha Pjetrit: ''Shporru prej meje, o Satan!... sepse s'ke ndër mënd punët e Perëndisë, por punët e njerëzve''.
Gjoni 12:32-33.....32 Dhe unë, kur të jem ngritur lart nga toka, do t'i tërheq të gjithë tek unë''. 33 Por ai i thoshte këto për të treguar nga ç'lloj vdekje duhet të vdiste.

Shënim: Në Kura'n s'ka vargje ku Jezusi tregon që do të vritet nga judenjtë.

88.*

A pranohet se Krishti vdiq fizikisht në kryq dhe u ngjall prej së vdekurish?

Bibla Po / Jo Kurani

Mateu 27:50.....Dhe Jezusi bërtiti edhe një herë me zë të lartë dhe dha frymë.

Gjoni 19:30.....Kur Jezusi e mori uthullën, tha: ''U krye!'' . Dhe duke ulur kryet, dha frymën.

1 Korintasve 15:3-4*.....3 se Krishti vdiq për mëkatet tona sipas Shkrimeve, 4 se u varros dhe u ringjall të tretën ditë, sipas Shkrimeve,

Nisa 4:157*.....madje për shkak të thëhies së tyre: "Ne e kemi mbytur mesihun, Isain, birin e Merjemes, të dërguarin e All-llahut". Po ata as nuk e mbytën as nuk e gozhduan (nuk e kryqëzuan në gozhda), por atyre u përngjau. Ata që nuk u pajtuan rreth (mbyttjes së) tij, janë në dilemë për të (për mbytje) e nuk kanë për të kurrfarë dije të saktë, përveç që iluzojnë. E ata me siguri nuk e mbytën atë.

89.*

A pranohet se Krishti është i gjallë sot dhe se do të rikthehet?

Bibla Po / Po Kurani

Gjoni 14:2-3*.....2 Në shtëpinë e Atit tim ka shumë banesa; përndryshe do t'ju thoja. Unë po shkoj t'ju përgatis një vend. 3 Dhe kur të shkoj e t'ju përgatis vendin, do të kthehem dhe do t'ju marr pranë meje, që aty ku jam unë, të jeni edhe ju.

Zbulesa 22:12 & 20*.....12 Dhe ja, unë vij shpejt, dhe shpërblimi im është me mua, për t'i dhënë gjithsecilit sipas veprave që ai ka bërë. 20 Ai që dëshmon për këto gjëra, thotë: "'Po, unë vij shpejt. Amen'". Po, eja, Zoti Jezus.

Nisa 4:158*.....Përkundrazi, All-llahu e ngriti atë pranë Vetes.

Zuhruf 43:61*.....E ai (Isai) është parashenjë e momentit (e kijametit), pra kurrsesi mos dyshoni në të (në katastrofë) dhe eni pas meje kjo është rrugë e drejtë.

Shënim: Ka 73 vargje në Bibël rreth ardhjes së dytë e Krishtit.

90.*

A ka vargje në Bibël që "parashikojnë" ose "parathonë" ardhjen e Muhamedit?

Bibla Jo / Po Kurani

Mateu 24:11 & 26*.....11 Dhe do të dalin shumë profetë të rremë, dhe do të mashtrojnë shumë njerëz. 26 Pra, në qoftë se ju thonë: "Ja, është në shkretëtirë", mos shkoni atje:

Gjoni 5:31*.....Nëse unë dëshmoj për veten time, dëshmia ime nuk është e vërtetë.

A'raf 7:157*.....Që pranojnë të dërguarin (Muhammedin), Pejgamberin arab, (që nuk shkruan as nuk lexon), të cilin e gjejenë të cilësuar (të përshkruar me virtytet e tij), te ata në Tevrat dhe në Inxhil,

Saf 61:6*.....Dhe, kur Isai, biri i Merjemes tha: "O beni israilë, unë jam i dërguar i All-llahut te ju, jam vërtetues i Tevratit që ishte para meje dhe jam përgëzues për një të dërguar që do të vijë pas meje, emri i të cilit është Ahmed!"

91.*

Që Muhamedi të plotësonte kriteret e një profeti që do të transmetonte orakujt e shkruajtur të Perëndisë, a duhet të kishte qenë ai jude që dinte të shkruante dhe lexonte?

Bibla Po / Jo Kurani

Gjoni 4:22.....sepse shpëtimi vjen nga Judenjtë.

Romakeve 3:1-2*.....1 Cila është, pra, përparësia e Judeut, ose cila është dobia e rrethprerjes? 2 E madhe në çdo mënyrë; para së gjithash sepse orakujt e Perëndisë iu besuan atyre.

Romakeve 9:4*.....të cilët janë Izraelitë dhe atyre u përket birëria, lavdia, besëlidhjet, shpallja e ligjit, shërbimi hyjnor dhe premtimet;

A'raf 7:157-158*.....157 Që pranojnë të dërguarin (Muhammedin), Pejgamberin arab, (që nuk shkruan as nuk lexon), 158 All-llahun dhe të dërguarin e Tij, pejgamberin e pashkolluar,

Shura 42:52*.....Po kështu me urdhërin tonë Ne te shpallëm edhe ty shpirtin (Kur'anin). Ti nuk ke ditur çka është libri (Kur'ani) as ç'është besimi,

92.

A është vetëshpallja e Muhamedit si profet provë ose fakt i vlefshëm për t'u quajtur profet?

Bibla Jo / Po Kurani

Gjoni 5:31 & 36*.....31 Nëse unë dëshmoj për veten time, dëshmia ime nuk është e vërtetë. 36 sepse veprat që Ati më ka dhënë të kryej, ato vepra që bëj unë, dëshmojnë për mua, se Ati më ka dërguar.

1 Korintasve 14:32-33.....32 Frymërat e profetëve u nënshtrohen profetëve, 33 sepse Perëndia nuk është Perëndi trazimi, por paqtimi si në të gjitha kishat e shenjtorëve.

2 Korintasve 13:1*.....''Çdo gjë do të qëndrojë me gojën e dy a tre dëshmitarëve''.

Rad 13:43*.....E ata që mohuan thonë: "Ti nuk je i dërguar!" Thuaj: "Mjafton që All-llahu është dëshmitarë midis meje dhe midis jush dhe (është dëshmitar) ai që ka njohuri të librit (të shpalljeve)".

Fetih 48:28*.....e mjafton All-llahu dëshmitar.

93.*

A përputhej plotësisht mesazhi i Muhamedit me mesazhin e Jezusit dhe atë të Profetëve të tjerë?

Bibla Jo / Po Kurani

Isaia 8:20*.....Përmbahuni ligjit dhe dëshmisë!
Në rast se një popull nuk flet në këtë mënyrë,
kjo do të thotë se ai nuk ka dritë.

1 Korintasve 14:32-33*.....32 Frymërat e profetëve u nënshtrohen profetëve, 33 sepse Perëndia nuk është Perëndi trazimi, por paqtimi si në të gjitha kishat e shenjtoreve.

Shu'ara 26:196-197*.....196 Dhe se ai (Kur'ani) është i përmendur edhe në librat e mëparshëm. 197 A nuk ishte për ata (për jobsimtarët mekas) argument, se atë e dinin dijetarët (ulemaja) e beni israilëve?

Fussilet 41:43*.....Ty nuk po të thuhet tjetër përveç asaj që u është thënë të dërguarve para teje.

94.*

A i dha Perëndia Muhamedit fuqi të mbinatyrshe për të bërë mrekulli të dukshme si Jezusi dhe Profetët e tjerë si konfirmim se ishte dërguar nga Perëndia?

Bibla Jo / Jo Kurani

Gjoni 5:36*.....sepse veprat që Ati më ka dhënë të kryej, ato vepra që bëj unë, dëshmojnë për mua, se Ati më ka dërguar.

Gjoni 14:11*.....Më besoni se unë jam në Atin dhe se Ati është në mua; në mos, më besoni për shkak të vet veprave.

En'am 6:37-38*.....37 Dhe thanë : "Përse të mos i zbret atij (Muhammedit) një mrekulli nga Zoti i tij?" Thuaj: "S'ka dyshim se All-llahu ka fuqi t'ia zbresë një mrekulli, por shumica e tyre nuk e dinë (se çka do t'i gjente më pas).

Yunus 10:20*.....Dhe thonin: "Përse nuk i vjen atij (Muhammedit) ndonjë mrekulli nga Zoti i tij?" Po ti thuaj: "E fshehta është (çështje) vetëm e All-llahut (Ai sjell mrekulli). Prandaj, ju pritni se edhe unë së bashku me ju po pres!"

Shënim: Gjendën 157 mrekulli të përshkruara të bërë nga Jezusi dhe profetët e tjerë në Bibël, but s'ka gjëra të tilla të shënuar për Muhamedin në Kura'n.

95.*

A kishte Muhamedi dhuntinë profetike për të qenë në gjendje për të "parashikuar" ose "parathënë" të ardhmen ashtu si Jezusi dhe Profetët e tjerë?

Bibla Jo / Jo Kurani

Ligji i Përtërirë 18:22*.....Kur profeti flet në emër të Zotit dhe kjo gjë nuk ndodh dhe nuk realizohet, kemi të bëjmë me një gjë që Zoti nuk e ka thënë;

1 Samuelit 9:9*.....(Në të kaluarën në Izrael, kur dikush shkonte për t'u këshilluar me Perëndinë, thoshte: "Çohu të shkojmë te shikuesi", sepse profeti i sotëm në të kaluarën quhej shikues).

Isaia 41:22*.....ose na njoftoni ç'ka për të ndodhur.

En'am 6:50*.....Thuaj: "Unë nuk u them juve se i kam në kompetencë depotë e All-llahut (e t'ju sjellë mrekulli), as nuk pretendoj se i di fshehtësitë (e t'ju tregojë se kur do t'ju vijë dënimi),

Ahkaf 46:9*.....e nuk e di se çka do të bëhet me mua e as me ju,

96.

A do Perëndia i Abrahamit ndonjëherë falë Muhamedin duke puthur Gurin e zi të Qabes apo falë nderimin e hyjnive pagane arabe të tij?

Bibla Jo / Po Kurani

Eksodi 20:3-5.....3 Nuk do të kesh perëndi të tjerë para meje. 5 Nuk do të përkulesh para tyre dhe as do t'i shërbesh, sepse unë, Zoti, Perëndia yt,

1 i Mbretërve 19:18*.....Por kam lënë në Izrael një tepriçë prej shtatë mijë njerëzish; të gjithë nuk janë gjunjëzuar përpara Baalit dhe nuk e kanë puthur me buzët e tyre".

2 Korintasve 6:16*.....16 Dhe çfarë marrëveshje ka tempulli i Perëndisë me idhujt? 17 Prandaj 'dilni nga mesi i tyre dhe ndahuni prej tyre, thotë Zoti, dhe mos prekni asgjë të ndyrë, dhe unë do t'ju pranoj,

Bakara 2:158*....."Safa" dhe "Merve" janë nga shenjat (për adhurim) e All-llahut, e kush e mësyen shtëpinë për haxh (Qaben për haxh), ose për umre (vizitë jashtë kohës së haxhit), nuk është mëkat për te t'i vizitojë ato dyja (të ece në ato dy vende).

Not: Hadis: Bukhari 2:667, 673-680 & Enam 6:103-109.

97.

A konsiderohet Muhamedi si qenie e zakonshme njerëzore që kishte nevojë të pendohen dhe të kërkonte falje për mëkatet e tij?

Bibla Po / Po Kurani

Predikuesi 7:20*.....Nuk ka në fakt asnjë njeri të drejtë mbi tokë që bën të mirën dhe të mos mëkatojë.

Mateu 3:2 & 8.....2 ''Pendohuni, sepse mbretëria e qiejve është afër!'' 8 Jepni pra fryte të denja të penesës!

Veprat 17:30.....Perëndia, pra, duke kaluar përmbi kohërat e padijes, i urdhëron të gjithë njerëzit dhe kudo që të pendohen.

1 Gjoni 1:8 & 10.....8 Po të themi se jemi pa mëkat, gënjej-më vetveten dhe e vërteta nuk është në ne. 10 Po të themi se s'kemi mëkatuar, e bëjmë atë gënjeshtar dhe fjala e tij nuk është në ne.

Nisa 4:106.....Kërko falje (për këtë) All-llahut.

Yusuf 12:53*.....Unë nuk e shfajsoj veten time, pse epshi është shumë nxitës për të keqen,

Muhammad 47:19.....kërko falje për mëkatin tënd, për të besimtarëve e të besimtareve,

Fatih 48:1-2*.....1 Ne ty të dhamë (vendosëm për) një fitore të sigurt. Ashtu që All-llahu (pas fitores) të liroi ty prej mëkateve (që t'i mbathën) të mëparëshme dhe prej atyre të mëvonshme (kur njerëzit do të pranojnë fenë islame dhe nuk do të jenë më mëkatarë)

98.

A konsiderohet Muhamedi si profeti i fundit dhe më i madhi?

Bibla Jo / Po Kurani

Zbulesa 1:1, 8 & 17*.....1 Zbulesa e Jezu Krishtit, 17 ''Mos u tremb! Unë jam i pari dhe i fundit,

Zbulesa 22:13 & 20*.....13 Unë jam Alfa dhe Omega, fillimi dhe mbarimi, i pari dhe i fundit''.

Ahزاب 33:40*.....Muhammedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj por ai ishte i dërguari i All-llahut dhe vulë e të gjithë pejgamberëve,

Shënim: Pritet që të kthehët Jezusi. Muhamedi nuk pritet të kthehët.

Njeriu dhe Mëkati

99.

Kur mëkatuan Adami dhe Eva, a ishte pasoja një ndarje themëlor midis Perëndisë dhe njeriut, që rezultoi në një nevojë që njeriu të shpëtohet nga dënimi i Perëndisë ndaj mëkatit?

Bibla Po / Jo Kurani

Zanafilla 2:16-17.....16 Dhe Zoti Perëndi e urdhëroi njeriun duke i thënë: "Ha bile lirisht nga çdo pemë e kopshtit; 17 por mos ha nga pema e njohjes të së mirës dhe të së keqes, sepse ditën që do të hash prej saj ke për të vdekur me siguri".

Romakeve 5:12-19*.....12 Prandaj, ashtu si me anë të një njeriu të vetëm mëkati hyri në botë dhe me anë të mëkatit vdekja, po ashtu vdekja u shtri tek të gjithë njerëzit, sepse të gjithë mëkatuan;

Bakara 2:35-38*.....35 Ne i thamë: "O Adem, ti dhe bashkëshortja jua j banoni në Xhennet dhe hani lirisht nga frutat e tij kah të doni, po mos iu afroni asaj bime (peme) e të bëheni zulumqarë (të vetvetes suaj). " 37 E Ademi prej Zotit të vet pranoi disa fjalë (lutje) , prandaj Ai ia fali (gabimin), s'ka dyshim se Ai është Mëshiruesi, Pendimpranuesi.

100.

A ka vargje që tregojnë se njerëzit kanë lindur me një natyrë mëkatore? (Mëkati i parë)

Bibla Po / Jo Kurani

Isaia 64:6*.....Jemi të gjithë si një gjë e papastër, dhe të gjitha veprat tona të drejtësisë janë si një rrobe e ndotur; po fishkemi të gjithë si një gjethe dhe paudhësitë tona na çojnë larg si era.

Romakeve 3:23.....sepse të gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë,

Taha 20:122*.....Mandej Zoti i vet atë të zgjedhur, ia pranoi pendimin dhe e vuri në rrugën e drejtë (të vendosur).

Tin 95:4*.....Vërtet, Ne e krijuam njerin në formën më të bukur.

Shënim: Islami e mohon doktrinën e mëkati i parë.

101.

A janë të gjithë njerëzit, përfshirë profetët, fajtorë për kryerje mëkati? (me përjashtim të Jezusit)

Bibla Po / Po Kurani

1 i Mbretërve 8:46.....Kur të mëkatojnë kundër teje (sepse nuk ka njeri që nuk mëkaton) dhe ti, **Psalmet 130:3**.....Në rast se ti do të merrje parasysh fajet, o Zot, kush mund të rezistonte, o Zot?

Fjalët e urta 20:9.....Kush mund të thotë: "Pastrova zemrën time, jam i pastruar nga mëkati im"?

Romakeve 3:10*.....siç është shkruar: "Nuk ka asnjëri të drejtë, as edhe një.

1 Gjoni 1:8.....Po të themi se jemi pa mëkat, gënjej-më vetveten dhe e vërteta nuk është në ne.

Yusuf 12:53.....Unë nuk e shfajsoj veten time, pse epshi është shumë nxitës për të keqen,

İbrahim 14:34*....Vërtet, njeriu është i padrejtë dhe shumë për përbuzës.

Nahl 16:61*.....Sikur All-llahu t'i dënonte njerëzit (zullumqarë) për shkak të mizorisë së tyre, nuk do të linte mbi të (tokë) asnjë gjallesë,

Shu'ara 26:82.....Ai te i cili kam shpresë se do të m'i falë mëkatet e mia në ditën e gjykimit.

Muhammad 47:19.....kërko falje për mëkatin tënd, për të besimtarëve e të besimtareve,

102.

A konsiderohej Maria, nëna e Jezusit, si person që kishte marrë si dhuratë cilësi hyjnore dhe a duhet adhuruar ajo si Nëna e Perëndisë?

Bibla Jo / Jo Kurani

Isaia 42:8*.....Unë jam Zoti, ky është emri im; nuk do t'i jap lavdinë time asnjë tjetri, as lavdërimet e mia **Gjoni 2:3-5***.....5 Nëna e tij u tha shërbëtorëve: "Bëni gjithçka që ai t'ju thotë!"

İsra 17:22-23*.....Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve.

Zariyat 51:56*.....Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë.

103.

A e ndan mëkati njeriun nga Perëndia dhe, si rrjedhojë, a përfundojnë njerëzit në ferr?

Bibla Po / Po Kurani

Ezekieli 18:4 & 20.....4 Shpirti që mëkaton ka për të vdekur. 20 Shpirti që mëkaton do të vdesë,

Luka 12:5*.....Unë do t'ju tregoj prej kujt duhet të keni frikë: druani nga ai që, pasi ka vrarë, ka pushtet të të hedhë në Gehena; po, po ju them, nga ai të keni frikë.

Zbulesa 20:13-15*.....15 Dhe, nëse ndokush nuk u gjet i shkruar në librin e jetës, u flak në liqenin e zjarrit.

A'raf 7:41*.....Për ata është përgattitur shtrat nga zjarri dhe mbulojë (mga zjarri). E kështu pra i shpërblejmë zullumqarët.

Yunus 10:27*.....E ata që bënë të këqia, dënimi i së keqes është aq sa është ajo, ata i mbulon poshtërimi. Ata janë banues të përjetshëm të zjarrit.

104.*

A i merr seriozisht mëkatet e vogla Perëndia i Shenjtë?

Bibla Po / Jo Kurani

Mateu 5:19.....Ai, pra, që do të shkelë një nga këto urdhërime më të vogla, dhe do t'u ketë mësuar kështu njerëzve, do të quhet më i vogli në mbretërinë e qiejve;

Mateu 12:36*.....Por unë po ju them se ditën e gjyqit njerëzit do të japin llogari për çdo fjalë të kotë që kanë thënë.

1 Korintasve 5:6*.....Mburra juaj nuk është e mirë. A nuk e dini se pak maja e mbrun gjithë brumin?

Jakobi 2:10.....Sepse kushdo që e zbaton gjithë ligjin, por e shkel në një pikë, është fajtor në të gjitha pikat.

Ahzab 33:5*.....Nuk ëshë ndonjë mëkat juaji ajo për çka keni gabuar, por (është mëkat) ajo që zemrat tuaj e bëjnë qëllimisht,

Nejm 53:31-32*.....Ata që largohen prej mëkateve të mëdha dhe prej punëve të ndyta, përpos ndonjë pune të imët, s'ka dy-shim se Zoti yt gjerësisht përfshin me falje, se Ai di më së miri për ju edhe para se t'ju krijojë, kur filloi krijimin tuaj nga dheu ndërsa ju ishit të fshehur në barqet e nënave tuaja.

105.*

A është dënim i përshtatshëm t'i presësh duart një hajduti?

Bibla Jo / Po Kurani

Eksodi 22:1-4*.....1 Në rast se ndokush vjedh një ka a një dele dhe i vret ose i shet, do të kthejë pesë qe për kaun dhe katër dele për delen. **4** Në rast se gjëja e vjedhur, qoftë ka ose gomar ose dele, gjendet e gjallë në duart e tij, do të kthejë dyfishin e saj.

Fjalët e urta 6:30-31*.....30 Nuk përçmohet hajduti që vjedh për të shuar urinë kur është i uritur; **31** por në rast se kapet në faj, duhet të kthejë shtatëfishin, dhe të japë tërë pasurinë e shtëpisë së tij.

Maide 5:38*.....Vjedhësit dhe vjedhësit preniu duart, si shpagim i veprës që bën, (kjo masë është) dënim nga All-llahu.

106.

A është e pranueshme që nganjëherë një besimtar të gënjejë ose mashtrojë të tjerët për të mbrojur veten? (Takija)

Bibla Jo / Po Kurani

Fjalët e urta 6:16-17*.....16 Zoti i urren këto gjashtë gjëra, madje shtatë janë të neveritshme për të: **17** sytë krenare, gjuha gënjeshtare, duart që derdhin gjak të pafajshëm,

Efesianeve 4:25*.....Prandaj, duke e lënë mënjanë gënjeshtren, secili t'i thotë të vërtetën të afërmit të vet,

Zbulesa 21:8*.....dhe gjithë gënjeshtarët, pjesa e tyre do të jetë në liqenin që digjet me zjarr dhe sqfur,

Bakara 2:225*.....All-llahu nuk ju merr në përgjegjësi për betimet tuaja të paqëllimta, por ju merr për ato që i bëni qëllimisht me gjithë zemër.

Tahrim 66:2*.....All-llahu u ka përcaktuar juve zgjidhjen e betimeve tuaj; All-llahu është kujdestari juaj; Ai është i gjithdijshmi, i urti.

Shënim: Taqiyya = Të tregosh një gjë jo të vërtetë. Kitman = të tregosh duke shmangur të tregurit të së vërtetës.

107.

A shihet homoseksualiteti si mëkat, që ndalohet dhe dënohet?

Bibla Po / Po Kurani

Levitivo 18:22..... Nuk do të kesh marrëdhënie seksuale me një burrë, ashtu si bëhet me një grua; është një gjë e neveritshme.

Levitivo 20:13*.....Në qoftë se dikush ka marrëdhënie seksuale me një burrë ashtu si ato që bëhen me një grua, që të dy kanë kryer një degjenerim të neveritshëm, do të dënohen pa tjetër me vdekje; gjaku i tyre do të bjerë mbi ta.

A'raf 7:80-81*.....80 Përkujto kur popullit të vet Luti i tha: "A punoni të shëmtuaren, që asnjë nga popujt e botës nuk e bëri para jush". Vërtet, ju të shtyrë nga epshet u afroheni burrave duke i lënë gratë. Po ju jeni popull i shfrenuar".

Neml 27:54-55*.....55 A vërtet, ju nga epshi kontaktoni me meshkujt, e braktisni gratë tuaja?

108.

A shihet aborti dhe vrasje si mëkat, që ndalohet dhe dënohet?

Bibla Po / Po Kurani

Zanafilla 9:6-7*.....6 Cilido që derdh gjakun e një njeriu, gjaku i tij do të derdhet nga një njeri, sepse Perëndia e ka krijuar njeriun simbas shëmbëlltyrës së tij. 7 Ju, pra, jini frytdhënës dhe shumëzohuni; rrituni me të madhe në tokë dhe shumëzohuni në të".

Eksodi 20:13.....Nuk do të vrasësh.

Fjalët e urta 6:16-17*.....16 Zoti i urren këto gjashtë gjëra, 17 duart që derdhin gjak të pafajshëm

Maide 5:32.....Për këtë (shkak të atij krimi) Neu shpallëm (ligji) beni israilve se kush mbyt një njeri (pa të drejtë), pa pasë mbytur ai ndonjë tjetër dhe p pasë bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si t'i kishte mbytur gjithë njerëzit.

Ësra 17:31*.....Ju mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë, se Ne ua sigurojmë furnizimin atyre dhe juve, e mbytja e tyre është mëkat i madh.

109.*

A mund të fshihet dënimi për mëkatin duke bërë "vepra të mira"? (Sevap)

Bibla Jo / Po Kurani

Romakeve 3:28*.....Ne, pra, konkludojmë se njeriu është i shfajësuar nëpërmjet besimit pa veprat e ligjit.

Galatasve 3:11.....Sepse me anë të ligjit askush nuk shfajësohet përpara Perëndisë, sepse: "I drejti do të rrojë me anë të besimit".

Titit 3:5-6.....5 ai na shpëtoi jo me anë të veprave të drejta që ne bëmë, por sipas mëshirës së tij, me anë të larjes së rilindjes dhe të ripërtëritjes së Frymës së Shenjtë,

Hud 11:114....S'ka dyshim se vepra e mira i shlyejnë ato të këqiat.

Ankebut 29:7*....Po ata që besuan dhe bënë vepra të mira, Ne me siguri do t'ua shlyejmë të këqijat do t'i shpërblejmë më së miri për atë që vepruan.

Nejm 53:32.....Ata që largohen prej mëkateve të mëdha dhe prej punëve të ndyta, përpos ndonjë pune të imët, s'ka dyshim se Zoti yt gjerësisht përfshin me falje,

Shpëtimi

110.

A lindët njëri si "i Krishterë" apo "Mysliman"?

Bibla Jo / Po Kurani

Gjoni 1:12-13*.....12 por të gjithë atyre që e pranuan, ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë, atyre që besojnë në emrin e tij, 13 të cilët nuk janë lindur nga gjaku, as nga vullneti i mishit, as nga vullneti i burrit, por janë lindur nga Perëndia.

Kâfirûn 109:1-6*.....6 Ju keni fenë tuaj (që i përmbaheni), e unë kam fenë time (që i përmbahem)!

Shënim: Sipas Biblës asnjëri nuk mund të lindë si i Krishterë. Vetëm ata që janë "rilindur" nga Fryma e Perëndisë do të trashëgojnë Mbretërinë e Perëndisë. Kurse një i lindur nga një atë Mysliman, automatikisht konsiderohet të qënurit Mysliman pas lindjes.

111.*

A varet shpëtimi i një njeriu nga veprat e tij/saj të mira ? (Ameller)

Bibla Jo / Po Kurani

Romakeve 4:2.....Sepse nëse Abrahami ishte shfajësuar nëpërmjet veprave, ai ka përse të lëvdohet; ndërsa përpara Perëndisë ai nuk ka asgjë për t'u lëvduar.

Efesianeve 2:8-9*.....8 Ju në fakt, jeni të shpëtuar me anë të hirit, nëpërmjet besimit, dhe kjo nuk vjen nga ju, po është dhurata e Perëndisë, 9 jo nga vepra, që të mos mburret askush.

Titit 3:5-6*.....5 ai na shpëtoi jo me anë të veprave të drejta që ne bëmë, por sipas mëshirës së tij, me anë të larjes së rilindjes dhe të ripërtëritjes së Frymës së Shenjtë, 6 të cilën e derdhi me mbushëlli mbi ne, me anë të Jezu Krishtit, shpëtimtarit tonë,

Hud 11:114*....S'ka dyshim se vepra e mira i shlyejnë ato të këqiat.

Ankebut 29:7*.....Po ata që besuan dhe bënë vepra të mira, Ne me siguri do t'ua shlyejmë të këqijat do t'i shpërblejmë më së miri për atë që vepruan.

112.

A është gjithmonë shpengimi përmes një flijimi me gjak kushti i Perëndisë për të sjellë shpëtimin nga dënimi për mëkatin? (Kefaret)

Bibla Po / Jo Kurani

Levitivo 17:11*....Sepse jeta e mishit është në gjak. Prandaj ju kam urdhëruar ta vini mbi altar për të bërë shlyerjen për jetën tuaj, sepse është gjaku që bën shlyerjen e fajit për jetën.

Hebrenjte 9:12 & 22*.....22 Dhe sipas ligjit, gati të gjitha gjërat pastrohen me anë të gjakut; dhe pa derdhur gjak nuk ka ndjesë.

Bakara 2:48*.....Dhe ruajuni një ditë kur askush askujt nuk do të mund t'i kryej asgjë, kur nuk pranohet për te (jobesimtarin) ndonjë ndërmjetësim dhe nuk pranohet për te kompensim,

Hajj 22:37*.....te All-llahu nuk arrin as mishi as gjaku i tyre, por te Ai arin bindja e juaj.

113.

A mund të merret shpëtimi i siguruar i Perëndisë vetëm përmes hirit, nëpërmjet besimit në shpengimin flijues të Qengjit të Perëndisë? (Jezus Krishti)

Bibla Po / Jo Kurani

Gjoni 1:29.....Të nesërmen, Gjoni e pa Jezusin që po vinte drejt tij dhe tha: "Ja, Qengji i Perëndisë, që heq mëkatin e botës!

Romakeve 3:24-28*.....24 por janë shfajësuar falas me anë të hirit të tij, nëpërmjet shpengimit që është në Krishtin Jezus. 25 Atë ka paracaktuar Perëndia për të bërë shlyerjen nëpërmjet besimit në gjakun e tij,

Efesianeve 1:7*.....në të cilin kemi shpengimin me anë të gjakut të tij, faljen e mëkateve sipas pasurivë së hirit të tij,

Efesianeve 2:8.....Ju në fakt, jeni të shpëtuar me anë të hirit, nëpërmjet besimit, dhe kjo nuk vjen nga ju, po është dhurata e Perëndisë,

En'am 6:164.....Askush nuk do të bartë barrën e tjetrit.

Ësra 17:15*.....e askushnuk do ta batë barrën e tjetrit.

Nejm 53:38*....(Në të cilat shkruan) Se askush nuk e bartë barrën e tjetrit

114.

Që një njeri të shkojë në qiell a duhet fillimisht të kuptojë mesazhin e ungjillit dhe të pranojë Mesian, Jezus Krishtin si Zot dhe Shpëtimtar?

Bibla Po / Jo Kurani

Romakeve 10:9-10 & 17*.....9 sepse, po të rrëfesh me gojën tënde Zotin Jezus, dhe po të besosh në zemrën tënde se Perëndia e ngjalli prej së vdekurish, do të shpëtohesh. 10 Sepse me zemër, njeriu beson në drejtësi dhe me gojë bëhet rrëfim për shpëtim,

Bakara 2:119-120*.....119 Ne të dërguam ty (o Muhammed a. s.) me të Vërtetën (Islamin), përgëzues dhe nedhir (vërejtës, qortues, paralajmërues), 120 As jehuditë, e as krishterët kurrë nuk do të jenë të kënaqur me ty deri që të pasosh fenë e tyre. Thuaju: "Udhëzimi i All-llahut është udhëzim i drejtë.

115.*

A pranohet se besimi në Jezus Krishtin si Shpëtimtar dhe Zot është mënyra e vetme që mëkatet e dikujt të falen dhe ky njeri të marrë jetën e përjetshme?

Bibla Po / Jo Kurani

Gjoni 11:25.....Jezusi i tha: "Unë jam ringjallja dhe jeta; ai që beson në mua, edhe sikur të duhej të vdesë do të jetojë.

Gjoni 14:6.....Jezusi i tha: "Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje.

Gjoni 17:3.....Dhe kjo është jeta e përjetshme, të të njohin ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që ti ke dërguar.

Al-i İmran 3:19-20*.....19 Pa dyshim feja te All-llahu është Islami. U kundërshtuan ata që u është dhënë libri, pasi që u erdhi e vërteta, nga zilia mes vete. 20 Nëse janë nënshtruar, atëherë janë përudhur e nëse refuzojnë, vërtet ti ke (për obligim vetëm) komunikimin;

116.

A kërkohet që një besimtar të pagëzohet në ujë sot?

Bibla Po / Jo Kurani

Mateu 28:19-20*.....19 Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë, 20 dhe duke i mësuar të zbatojnë të gjitha gjërat që unë ju kam urdhëruar.

Marku 16:16.....ai që beson dhe është pagëzuar, do të jetë i shpëtuar; por ai që nuk ka besuar, do të jetë i dënuar.

Veprat 2:38*.....Atëherë Pjetri u tha atyre: "Pendohuni dhe secili nga ju le të pagëzohet në emër të Jezu Krishtit për faljen e mëkateve, dhe ju do të merrni dhuratën e Frymës së Shenjtë.

Veprat 22:16.....Dhe tani ç'pret? Çohu dhe ji i pagëzuar dhe i larë nga mëkatet e tua, duke thirrur emrin e Zotit".

Shënim: Nuk gjendët asnjë varg në Kura'n që flet për pagëzimin në ujë.

117.

A është rrethprerja e domosdoshme për një besimtar mashkull sot?

Bibla Jo / Po Kurani

1 Korintasve 7:18 & 20*.....18 A u thirr ndokush kur ishte i rrethprerë? Le të mos bëhet i parrethprerë. Dikush u thirr kur ishte i parrethprerë? Le të mos rrethprietet. 20 Gjithsecili le të mbetet në atë gjendje në të cilën ishte thirrur.

Galatasve 5:2.... Ja, unë, Pali, po ju them se, në qoftë se rrethprienti, Krishti nuk do t'ju bëjë dobi aspak.

Galatasve 5:6*.....sepse në Jezu Krishtin, as rrethprerja, as parrethprerja s'kanë ndonjë vlerë, por besimi që vepron me anë dashurie.

Nahl 16:123*.....Pastaj, ty të shpallëm: "Ndiqe fenë e drejtë të Ibrahimit, se ai nuk ka qenë nga idhujtarët.

Shënim: Ne Islam, rrethprerja është pjesë e fesë e Abrahamit dhe kështu e detyrueshme për Muslimet. Kjo shihet edhe në Hadith: Bukhari 1252, Fatih al-Bari 6:388, Muslim 4:2370.

118.

A ka vargje që i urdhërojnë njerëzit të jenë "të shenjtë" dhe a është "shenjtëria" parakriter për të shkuar në parajsë?

Bibla Po / Jo Kurani

Levitivo 11:44*.....Sepse unë jam Zoti, Perëndia juaj; shenjtërohuni, pra, dhe jini të shenjtë, sepse unë jam i shenjtë;

1 Korintasve 3:16-17.....16 A nuk e dini ju se jeni tempulli i Perëndisë dhe se Fryma e Perëndisë banon në ju? 17 Në qoftë se dikush e prish tempullin e Perëndisë, Perëndia do ta prishë atë, sepse tempulli i Perëndisë, i cili jeni ju, është i shenjtë.

Hebrenjte 12:14*.....Kërkoni paqe me të gjithë dhe shenjtërim, pa të cilin askush nuk ka për të parë Perëndinë,

1 Pjetri 1:16....Jini të shenjtë, sepse unë jam i shenjtë

Shënim: Nuk gjenden vargje ne Kura'n që i urdhërojnë njerëzve të jenë shenjtë apo që ndikojnë që mund të jenë të shenjtë.

119.

A mund të zgjedhin njerëzit të bëhen fëmijë të Perëndisë duke ushtruar vullnetin e tyre të lire dhe dëshirën e tyre?

Bibla Po / Jo Kurani

Gjoni 1:12*.....por të gjithë atyre që e pranuan, ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë, atyre që besojnë në emrin e tij,

Romakeve 8:14 & 16.....14 Sepse të gjithë ata që udhëhiqen nga Fryma e Perëndisë janë bij të Perëndisë. 16 Vetë Fryma i dëshmon frymës sonë se ne jemi bij të Perëndisë.

Galatasve 3:26*.....sepse të gjithë ju jeni bij të Perëndisë me anë të besimit të Jezus Krishti.

Hebrenjete 12:5-6.....6 sepse Perëndia ndreq atë që do dhe fshikullon çdo bir që i pëlqen''.

Maide 5:18*.....Jehuditë dhe të krishterët thanë: "Ne jemi bijtë e All-llahut dhe të dashurit e Tij". Thuaju: "E pse pra, Ai ju dënon me mëkatet tuaja?" Jo, ju jeni njerëz që Ai ju krijoi.

120.*

A është fati i një njeriu plotësisht i parapërcaktuar ose i paracaktuar nga Perëndia? (Kader apo Kismet)

Bibla Jo / Po Kurani

Ligji i Përtërirë 30:19*.....Unë marr sot si dëshmitarë kundër teje qiellin dhe tokën, që unë të kam vënë përpara jetës dhe vdekjes, bekimit dhe mallkimit; zgjidh, pra, jetën që të mund të jetoni ti dhe pasardhësit e tu,

Jozueu 24:15*.....zgjidhni sot kujt doni t'i shërbeni...

Tevbe 9:51*.....Thuaj: "Neve nuk na godet asgjë tjetër, përveç çka na ka caktuar All-llahu;

Kasas 28:68.....atyre nuk u takon zgjedhja.

Ahzab 33:38*.....e urdhëri i All-llahut është vendim i kryer.

Shënim: Nga të Krishterët: Arminianet do të thonë "Po", kurse Kalvinistet do të thonë "Po".

121.

A përdor Perëndia peshore për të peshuar veprat e mira dhe ato të këqija për të përcaktuar nëse dikush do të shkojë në parajsë apo në ferr? (Terazi)

Bibla Jo / Po Kurani

Efesianeve 2:8-9*.....8 Ju në fakt, jeni të shpëtuar me anë të hirit, nëpërmjet besimit, dhe kjo nuk vjen nga ju, po është dhurata e Perëndisë, 9 jo nga vepra, që të mos mburret askush.

Titit 3:4-5*.....4 Po kur u shfaq mirësia e Perëndisë, Shpëtimtarit tonë, dhe dashuria e tij për njerëzit, 5 ai na shpëtoi jo me anë të veprave të drejta që ne bëmë, por sipas mëshirës së tij, me anë të larjes së rilindjes dhe të ripërtëritjes së Frymës së Shenjtë,

A'raf 7:8-9.....8 Atë ditë eshimi (masa) është i drejtë. Atij që i rëndohen peshojat ,ata janë të shpëtuar. 9 Kujt i vijnë lehtë peshojat, ata e humben vetveten, ngase i refuzan argumentet Tona me të padrejtë.

Mü'minun 23:102-103*.....102 E kujt i peshojnë më rëndë peshojat (veprate mira), ata jamë të shpëtuarit. 103 Ndërsa, atyre që u peshojnë lehtë, peshojat (veprat e mira), ata janë që humben vetveten dhe janë në Xhehennem përgjithmonë.

122.*

Që një njeri të hyjë në Mbretërinë e Perëndisë, a është fillimisht e nevojshme që të ketë një "rilindje shpirtërore" dhe të "rilindë"?

Bibla Po / Jo Kurani

Gjoni 3:3*.....Jezusi iu përgjigj dhe tha: "'Në të vërtetë, në të vërtete po të them që nëse një nuk ka rilindur, nuk mund ta shohë mbretërinë e Perëndisë'".

2 Korintasve 5:17.....Prandaj nëse dikush është në Krishtin, ai është një krijesë e re;

1 Pjetri 1:23*.....sepse jeni ringjizur jo nga një farë që priset, por që nuk priset, me anë të fjalës së Perëndisë së gjallë dhe që mbetet përjetë.

Shënim: Kuran'i nuk tregon fare për nevojën për rilindjen frymërore apo të qënurit i "rilindur".

123.*

A ua jep Perëndia të gjithë besimtarëve të vërtetë të Krishtit premtimin ose garancinë e jetës së përjetshme?

Bibla Po / Po Kurani

Gjoni 3:36....Kush beson në Birin ka jetë të përjetshme, kurse kush nuk i bindet Birit nuk do të shohë jetë, por zemërimi i Perëndisë qëndron mbi të''.

Gjoni 5:24*.....Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them: Ai që e dëgjon fjalën time dhe beson në atë që më ka dërguar, ka jetë të përjetshme, dhe ai nuk vjen në gjyq, por ka kaluar nga vdekja në jetë.

Al-i İmran 3:55 & 113-115*.....55 (Përkujto, o i dërguar) Kur All-llahu tha: 'O Isa... E ata që të besuan ty, do t'i ngrisë lart mbi ata që nuk besuan deri në ditën e kijametit , 113 Nga ithtarët e librit ka që janë në rrugë të drejtë, gjatë natës lexojnë ajetet e All-llahut duke u lutur.

Maide 5:47 & 69*.....47 (E zbritëm) Që ithtarët e Inxhilit të gjykojnë sipas asaj që All-llahu e zbriti në të. E kush nuk gjykon sipas asaj që All-llahu e zbriti, të tillët janë mëkatarë të dalë jashtë rrugës së Zotit.

Gjërat e së Ardhmes

124.*

A përdoren fjalët "profet" dhe "profeci" në rradhë të parë për një njeri që nëpërmjet dhuntisë nga Perëndia ka njohuri për gjërat e së ardhmes? (Nebi)

Bibla Po / Jo Kurani

1 Samuelit 9:9*.....(Në të kaluarën në Izrael, kur dikush shkonte për t'u këshilluar me Perëndinë, thoshte: "Çohu të shkojmë te shikuesi", sepse profeti i sotëm në të kaluarën quhej shikues).

Zbulesa 19:10*.....Sepse dëshmia e Jezusit është frymë e profecisë''.

Ahkaf 46:9*.....e nuk e di se çka do të bëhet me mua e as me ju, unë nuk ndjek tjetër vetëm atë që më shpallet, unë nuk jam tjetër pos i dërguar që ju trheq qartas''.

125.*

A është dhënë informacion i hollësishëm për ngjarjet e fundit të botës? (Eskatologji / Gaib Haber)

Bibla Po / Jo Kurani

Mateu 24:3, 14 & 25*.....3 'Na thuaj, kur do të ndodhin këto gjëra? Dhe cila do të jetë shenja e ardhjes sate dhe e mbarimit të botës?'. 14 Dhe ky ungjill i mbretërisë do të predikohet në gjithë botën si një dëshmi për gjithë kombet, dhe atëherë do të vijë mbarimi'. 25 Ja, unë ju paralajmërova.

Zbulesa 1:1*.....Zbulesa e Jezu Krishtit, që Perëndia ia dha për t'u treguar shërbëtorëve të tij gjërat që duhet të ndodhin për së shpejti dhe e bëri të ditur,

En'am 6:50*.....Thuaj: "Unë nuk u them juve se i kam në kompetencë depotë e All-llahut (e t'ju sjellë mrekulli), as nuk pretendoj se i di fshehtësitë (e t'ju tregojë se kur do t'ju vijë dënimi), as nuk u them se unë jam engjëll. Unë ndjek vetëm atë që më shpallet mua.

126.

A gjenden vargje profetike që parashikojnë ardhjen e një sundimtari të fuqishëm satanik botërore që do të vijë në ditët e fundit? (Antikrishti / Mehdi)

Bibla Po / Jo Kurani

Mateu 24:21-25*.....24 Sepse do të dalin krishtër të rremë dhe profetë të rremë, dhe do të bëjnë shenja të mëdha dhe mrekulli të tilla aq sa t'i mashtrojnë, po të ishte e mundur, edhe të zgjedhurit.

2 Selanikasve 2:7-9*.....8 Atëherë do të shfaqet ky i paudhë, të cilin Zoti do ta shkatërrojë me hukatjen e gojës së tij dhe do ta asgjësojë me të dukurit e ardhjes së tij.

1 Gjoni 2:18*.....Fëmijë, është ora e fundit. Dhe, sikurse e dëgjuat, antikrishti duhet të vijë, dhe tani janë shfaqur shumë antikrishtë;

Zbulesa 6:2*.....dhe atij iu dha një kurorë, dhe ai doli jashtë si fitimtar dhe për të fituar.

Shënim: Kura'ni nuk tregon për ardhjen e Antikrishtit apo Mehdiut.

127.*

A do të ketë një "Ditë Gjykimi", kur Perëndia do të ngjallë çdo njeri prej së vdekurish dhe do të gjykojë nëse një njeri do të shkojë në parajsë apo në ferr? (Ahiret Gyny)

Bibla Po / Po Kurani

Hebrenjte 9:27.....Dhe, duke qenë se është caktuar që njerëzit të vdesin vetëm një herë, dhe më pas vjen gjyqi
2 Pjetri 2:9.....Zoti di t'i shpëtojë nga tundimi të perëndishmit dhe t'i ruajë të padrejtët që të ndëshkohen ditën e gjyqit,

Zbulesa 20:11-15*.....12 dhe të vdekurit u gjykuan në bazë të gjërave të shkruara në libra, sipas veprave të tyre. 15 Dhe, nëse ndokush nuk u gjet i shkruar në librin e jetës, u flak në liqenin e zjarrit.

Bakara 2:113*.....Po në ditën e gjykimit për atë që ata nuk pajtoheshin, All-llahu gjykon ndërmjet tyre.

Al-i İmran 3:185*.....Secili njeri do të shijojë vdekjen, e shpërblimet tuaja u plotësohen ditën e kijametit, e kush shmanget zjarrit e futet në Xhennet,

128.*

A do t'i duhet çdokujt të kalojë një periudhë vuajtjeje në ferr?

Bibla Jo / Po Kurani

Gjoni 5:24*.....Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them: Ai që e dëgjon fjalën time dhe beson në atë që më ka dërguar, ka jetë të përjetshme, dhe ai nuk vjen në gjyq, por ka kaluar nga vdekja në jetë.

Romakeve 8:1*.....Tani, pra, nuk ka asnjë dënim për ata që janë në Krishtin Jezu, që nuk ecin sipas mishit, por sipas Frymës,

Al-i İmran 3:185.....e kush shmanget zjarrit e futet në Xhennet, ai ka arritur shpëtim,

Meryem 19:70-72*.....70 E Ne e dujmë më së miri se cili prej tyre ka më meritë të hudhet në të. 71 Dhe nuk ka asnjë prej jush që nuk do t'i afrohet atij. Ky (kontaktim i Xhehennemit) është vendim i kryer i Zotit tënd. 72 Pastaj, (pas kalimit pran tij) do t'i shpëtojmë ata që ishin ruajtur (mekateve), e zullumçarët do t'i lëmë aty të gjunjëzuar.

129.*

Nëse dikush shkon në ferr, a ka ndonjë mundësi që të largohet më vonë e të shkojë në parajsë?

Bibla Jo / Po Kurani

Mateu 25:41 & 46*.....41 Pastaj ai do t'u thotë edhe atyre që do të jenë në të majtë: "Largohuni nga unë, të mallkuar, në zjarr të përjetshëm, të përgatitur për djallin dhe engjëjt e tij. 46 Dhe ata do të shkojnë në mundim të përjetshëm,

Luka 16:25-26*.....25 Por Abrahami thoshte: " tashti, përkundrazi, ai po përdëllehet dhe ti vuan. 26 Dhe, veç të gjithave, midis nesh dhe jush është një humnerë e madhe, kështu që ata që do të donin të kalonin që këtej tek ju nuk munden; po ashtu askush nuk mund të kalojë që andej te ne".

En'am 6:128*.....Tha: "(Zoti) Zjarri është vendi juaj, përgjithmonë jeni në të, pos (kohës) çka do All-llahu"

Hud 11:106-107*.....106 e për sa u përket atyre fatkëqinjeve, ata janë në zjarr, 107 Aty janë përgjithmonë, sa të jenë qiejt dhe toka, përveç atë çka do Zoti yt, vërtet Zoti yt punon çka dëshiron.

130.

A është trupi i ringjalljes trup fizik me mish, kocka dhe gjak?

Bibla Jo / Po Kurani

1 Korintasve 15:35-50*.....35 Por do të thotë ndonjë: "Si ringjallen të vdekurit, edhe me ç'trup do të vijnë?". 44 Mbillet trup natyror dhe ringjallet trup frymëror. Ka trup natyror, ka edhe trup frymëror. 50 Edhe këtë po ju them, o vëllezër, se mishi dhe gjaku nuk mund të trashëgojnë mbretërinë e Perëndisë,

Bakara 2:25 & 259*.....25 Aty do të kenë ata bashkëshorte të pastra dhe aty do të jenë përgjithmonë. 259 shiko se si i kombinojmë eshtrat e pastaj i veshim me mish.

Vakia 56:35-38.....35 Ne i kemi krijuar ato në një krijim të ri (formë të re). 36 Dhe ato i kemi bërë virgjëresha.

Nebe 78:33*.....Edhe vasha të një moshe.

131.*

A do të ketë marrëdhënie seksuale dhe martesë në parajsë? (Houris)

Bibla Jo / Po Kurani

Mateu 22:28-33*.....28 Në ringjallje, pra, e kujt nga këta të shtatë do të jetë grua? Sepse të gjithë e patën gruaja''. 29 Por Jezusi, duke u përgjigjur u tha atyre: ''Ju bëni gabim, sepse nuk e kuptoni as Shkrimin as pushtetin e Perëndisë. 30 Në ringjallje, pra, as martohen as martojnë, por ata do të jenë në qiell si engjëjt e Perëndisë.

1 Korintasve 15:50*.....Edhe këtë po ju them, o vëllezër, se mishi dhe gjaku nuk mund të trashëgojnë mbretërinë e Perëndisë,

Tur 52:20.....Ata janë të mbështetur në koltukë të renditur dhe Ne u shoqëruam atyre hyri symëdha.

Rahman 55:55-56, 70-72*.....56 Aty janë ato që përqëndrojnë shikimet e tyre (vetëm në burrat e vet) e që nuk i ka prekur kush para tyre, as njerëz, as xhin. 70-72. Ato janë hyri që e kufizojnë ndejën vetëm në shtëpinë (tënde).

132.

A konsiderohet Kisha mbarëbotërore të jetë "Nusja e Krishtit"?

Bibla Po / Jo Kurani

Efesianeve 5:23, 25, & 32*.....23 sepse burri është kreu i gruas, sikurse edhe Krishti është kreu i kishës, 25 Ju, burra, t'i doni gratë tuaja, sikurse edhe Krishti ka dashur kishën dhe e ka dhënë veten e vet për të, 32 Ky mister është i madh; tani unë e them në lidhjen me Krishtin dhe me kishën.

Zbulesa 19:7*.....Le të gëzohemi dhe të ngazëllohemi dhe le t'i japim atij lavdi, sepse erdhi dasma e Qengjit dhe nusja e tij është përgatitur!

Zbulesa 21:9.....''Eja, do të të tregoj nusen, gruan e Qengjit''.

Zbulesa 22:17.....Dhe Fryma dhe nusja thonë: ''Eja!''.

Shënim: Kura'ni e përmend Kishën vetëm një herë dhe nuk e përmend "Nusen e Krishtit": Hajj 22:40.

Çështje të Jetës Praktike

133.

A dëshiron Perëndia sot që besimtarët të jetojnë nën ligj? (Sherijat)

Bibla Jo / Po Kurani

Romakeve 6:14.....Në fakt mëkati nuk do të ketë më pushtet mbi ju, sepse nuk jeni nën ligj, por nën hir.

Romakeve 10:4.....sepse përfundimi i ligjit është Krishti, për shfajësimin e kujtdo që beson.

Galatasve 3:11 & 24-25*.....11 Sepse me anë të ligjit askush nuk shfajësohet përpara Perëndisë, sepse: 'I drejti do të rrojë me anë të besimit'. 24 Kështu ligji që mësuesi ynë për te Krishti, që ne të shfajësohemi me anë të besimit. 25 Por, mbasi besimi erdhi, ne nuk jemi më nën ndonjë mësues,

Maide 5:48*.....Për secilin prej jush, Ne caktuam ligje program

Jathiyah 45:18*.....Pastaj, Ne të vumë ty në një rrugë të drejtë të fesë, pra ti ndiqe atë

134.

A është e ndaluar që një besimtari të pijë verë?

Bibla Jo / Po Kurani

Luka 7:34-35.....34 Erdhi Biri i njeriut që ha dhe pi, dhe ju thoni: "Ja grykësi dhe pijaneci, miku i tagrambledhësve dhe i mëkatarëve". 35 Por urtisë i japin të drejtë gjithë bijtë e saj''.

Gjoni 2:1-11.....3 Duke qenë se mbaroi vera, nëna e Jezusit i tha: ''Nuk kanë më verë!''.

7 Jezusi u tha: ''Mbushni enët me ujë!''.

9 Dhe, mbasi i pari i festës e provoi ujin e shndërruar në verë

1 Timoteut 5:23*.....Mos pi më ujë, por përdor pak verë për stomakun tënd dhe për sëmundjet e tua të shpeshta.

Bakara 2:219.....Të pyesin ty për verën dhe bixhozin . Thuaj: "Që të dyja janë mëkat i madh,

Maide 5:90-91*.....90 O ju që besuat, s'ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, a po i jepni fund (alkoolit e bixhozit)?

135.

A është e ndaluar që një besimtar të hajë mish derri?

Bibla Jo / Po Kurani

Veprat 10:13-15*.....13 Dhe një zë i tha: "Pjetër, çohu, ther dhe ha!". 14 Por Pjetri u përgjigj:

"Kurrsesi, o Zot, sepse unë nuk kam ngrënë kurrë asgjë të papastër ose të ndotur!". 15 Dhe zëri i tha për të dytën herë: "Gjërat që Perëndia i ka pastruar, ti mos i bëj të papastra".

1 Korintasve 10:25*.....Hani çdo gjë që shitet te kasapi, pa bërë pyetje për shkak të ndërgjegjes,

Kolosianeve 2:16.....Prandaj askush të mos ju gjykojë për ushqime ose pije,

Maide 5:3*.....Juve u janë ndaluar (t'i hani): ngordhësira, gjaku, mishi i derrit, ajo që therret jo në emrin e All-llahut,

En'am 6:145*.....Thuaj: "Në atë që më është shpallur mua (në Kur'an) nuk po gjej diçka të ndaluar nga ushqimi, përveç në qoftë se ai (ushqimi) është: coftinë, gjak i derdhur ose mish derri, ai i ndytë,

136.

A pret Perëndia që besimtarët të agjërojnë sot?

Bibla Po / Po Kurani

Joeli 2:12.....Prandaj tani, thotë Zoti, "kthehuni tek unë me gjithë zemrën tuaj, me agjërimi, me lot dhe me vajtime".

Mateu 6:17-18.....17 Kurse ti, kur të agjërosh, vajose kokën dhe laje fytyrën,

Marku 2:20*.....Por do të vijnë ditët kur do t'u merret dhëndri dhe atëhëre, në ato ditë, ata do të agjërojnë.

Bakara 2:183 & 185*.....183 O ju që besuat, agjërimi (saum) u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm. 185 Muaji i Ramadanit që në te shpallet Kur'ani, E kush e përjeton prej jush këtë muaj, le të agjërojë,

Ahzab 33:35*.....agjëruesit dhe agjërueset... All-llahu ka përgatitur falje (mëkatesh) dhe shpërblim të madh.

137.

A parapëlqen Perëndia që lutja dhe agjërimi të bëhen publikisht, ku mund të shihen nga të tjerët?

Bibla Jo / Po Kurani

Mateu 6:5-8*.....6 Por ti, kur lutesh, futu në dhomëzën tënde, mbylle derën dhe lutju Atit tënd në fshehtësi; dhe Ati yt, që shikon në fshehtësi, do të ta shpërblejë publikisht.

Mateu 6:16-18*.....17 Kurse ti, kur të agjërosh, vajose kokën dhe laje fytyrën, 18 me qëllim që të mos u tregosh njerëzve se ti agjëron, por Atit tënd në fshehtësi;

Nisa 4:103*....pse namazi është obligim (për kohë) i caktuar për besimtarët.

Jumah 62:9*.....O ju që besuat, kur bëhet thirrja për namaz, ditën e zhumasë, ecni shpejt për aty ku përmendet All-llahu (dëgjojeni hutben, falnie namazin), e lini shitblerjen,

138.*

A dëshiron Perëndia që njerëzit të agjërojnë gjatë ditës e të bëjnë festë gjatë natës një muaj rresht gjatë vitit? (Ramazan)

Bibla Jo / Po Kurani

Isaia 58:3-7*.....6 Agjërimi që më pëlqen a nuk është vallë ky: të thyesh zinxhirët e ligësisë, të zgjidhësh verigat e zgjedhës, t'i lësh të lirë të shtypurit, të dërmosh çdo zgjedhë?

Mateu 6:16-18*.....17 Kurse ti, kur të agjërosh, vajose kokën dhe laje fytyrën, 18 me qëllim që të mos u tregosh njerëzve se ti agjëron, por Atit tënd në fshehtësi;

Bakara 2:183-185*.....183 O ju që besuat, agjërimi (saum) u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm. 185 Muaji i Ramadanit që në te shpallet Kur'ani... E kush e përjeton prej jush këtë muaj, le të agjërojë... Që të plotësoni numrin, të madhëroni All-llahun për atë se u udhëzoi dhe që të falenderoni.

139.

A pret Perëndia që besimtarët t'i japin të dhjetat dhe lëshoshë? (Zekat)

Bibla Po / Po Kurani

Malachi 3:8-10*.....8 Një njeri do të vjedhë Perëndinë? Megjithatë ju më vidhni dhe pastaj thoni: "Çfarë të kemi vjedhur?". Të dhjetën dhe ofertat.

Mateu 6:3*.....Madje kur jep lëshoshë, e majta jote të mos dijë ç'bën e djathta,

Mateu 19:21.....Jezusi i tha: "'Në goftë se do të jesh i përsosur, shko, shit ç'të kesh, jepua të varfërve dhe ti do të kesh një thesar në qiell; pastaj eja dhe më ndiq mua''.

Luka 11:41.....Por jepni si lëshoshë atë që është përbrenda, dhe çdo gjë do të jetë e pastër për ju.

Bakara 2:177*.....dhe ai që e fal namazin, e jep zeqatin,

Tevbe 9:103-104*.....103 Merr prej pasurisë së tyre lëshoshë që t'i pastrosh me të 104 All-llahu është ai që ranon pendimin e robëve të vet, pranon lëshoshat

Mu'minun 23:1 & 4.....1 Është e sigurtë se kanë shpëtuar besimtarët 4 dhe ata të cilët rregullisht japin zeqatin,

140.

A i pëlqen Perëndisë të dëgjojë lutje në formën e ritualit përsëritës pesë herë në ditë, çdo ditë në të njëjtën orë? (Namaz)

Bibla Jo / Po Kurani

Mateu 6:7*.....Por kur ju luteni, mos përdorni përsëritje të kota siç bëjnë paganët, sepse ata mendojnë se do t'u plotësohet lutja se kanë përdorur shumë fjalë.

Gjoni 4:24*.....Perëndia është Frymë, dhe ata që e adhurojnë duhet t'a adhurojnë në frymë dhe në të vërtetën''.

Hud 11:114.....Dhe fale namazin në dy skajet e ditës, e edhe në orët e aërta (me ditën) të natës.

Ësra 17:78*.....Fale namazin kur zbret (nga zeniti) dielli, e deri në errësirën e natës dhe duke bërë lutjen (namazin) e agimit.

141.

A pret Perëndia që besimtarët të shkojnë për peligrinazh në një vend të shenjtë të paktën një herë në jetën e tyre? (Haxh)

Bibla Jo / Po Kurani

Mateu 24:24-26.....26 Pra, në qoftë se ju thonë: "Ja, është në shkretëtirë", mos shkoni atje: "Ja, është në dhomat e fshehta", mos u besoni.

Gjoni 4:19-24*.....21 Jezusi i tha: "'O grua, më beso: vjen ora që as mbi këtë mal as në Jeruzalem nuk do të adhuroni Atin. 24. Perëndia është Frymë, dhe ata që e adhurojnë duhet t'a adhurojnë në frymë dhe në të vërtetën'".

Bakara 2:196*.....E kryenie haxhin dhe umrën për hir të All-llahut,

Al-i İmran 3:97*.....Për hirë të All-llahut, vizita eshtëpisë (Qabes) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi te ajo,

142.

A dëshiron Perëndia akoma që njerëzit të flijojnë kafshë një herë në vit? (Kurban)

Bibla Jo / Po Kurani

Psalmet 51:16-17*.....16 Ti në fakt nuk ndjen ndonjë kënaqësi në flijim, përndryshe do ta ofroja, nuk të pëlqen as olokausti. 17 Flijimet e Perëndisë janë frymë e thyer; o Perëndi, ti nuk e përçmon zemrën e thyer dhe të penduar.

Hebrenjte 9:11-12 & 25-28*.....11 Por Krishti, 26 por tani, vetëm një herë, në fund të shekujve Krishti u shfaq për të prishur mëkatën me anë të flijimit të vetvetes. 27 kështu edhe Krishti, pasi u dha vetëm njëherë për të marrë mbi vete mëkatët e shumëve,

Bakara 2:196*.....Po kush është prej jush i sëmurë ose ka mundim koke (e rruhet para kohe) kompensim është: agjërim, sadaka ose kurban.

Hajj 22:28 & 34*.....28 që ta përmendin All-llahun në ato ditë të caktuara (në shenjë falënderimi) dhe për që i ka furnizuar me kafshë. 34 Ne i kemi caktuar çdo populli vendtherrjen (e kurbanit), që ta përmendin emrin e All-llahut për arsye se i furnizoi ata me kafshët.

143.

Nëse një musliman ka pyetje për diçka në Bibël, a do të ishte e udhës të pyeste një të krishterë ose një jude për atë çështje?

Bibla Po / Po Kurani

1 Pjetri 3:15*.....madje shenjtëroni Zotin Perëndinë në zemrat tuaja dhe jini gjithnjë gati për t'u përgjigjur në mbrojtjen tuaj kujt do që ju kërkon shpjegime për shpresën që është në ju, por me butësi e me druajtje,

Yunus 10:94*.....Po, (fjala vjen) nëse je në dyshim për këtë që të zbritëm ty (për ngjarjet e pejgamberëve), atëherë pyeti ata që lexojnë librin para teje. Ty të erdhi nga Zoti yt e vërteta, pra, mos u bë prej atyre që dyshojnë.

Nahl 16:43*.....Ne as para teje nuk dërguam tjetër, përveç burra, të cilëve u dhamë shpallje. Ju (idhujtarë) pyetni pra dijetarët (e Tevratit e të Inxhilit) nëse ju nuk dini

144.

Nëse një besimtar ka rezerva për diçka në Librat e Shenjtë, a duhet të shmangë ai bërjen e pyetjeve të sigjerta që të shmangë përgjigje të papëlqyeshme?

Bibla Jo / Po Kurani

Veprat 17:11*....Por këta ishin më fisnikë nga ndjenjat se ata të Thesalonikit dhe e pranuan fjalën me gatishmëri të madhe, duke i shqyrtuar çdo ditë Shkrimet për të parë nëse këto gjëra ishin ashtu.

1 Gjoni 4:1*....Shumë të dashur, mos i besoni çdo frymë, por i vini në provë frymërat për të ditur nëse janë nga Perëndia, sepse shumë profetë të rremë kanë dalë në botë.

Bakara 2:108*.....A doni të pyetni të dërguarin tuaj sikurse u pyet më parë Musai.

Maide 5:101*.....O ju që besuat, mos pyetni për sende që, nëse u thuhet ajo (pyetja) haptazi, ju vjen keq juve, e nëse pyetni për to gjatë kohës kur zbritet Kur'ani, do t'ju dalë në shesh (dhe do ta ngarkoni veten pa nevojë).

145.

Jashtë zbulësës Hyjnore, a duhen marrë thëniet tradicionale dhe interpretimet njerëzore si të besueshme? (Hadith)

Bibla Jo / Po Kurani

Jeremia 17:5*.....Kështu thotë Zoti: "Mallkuar qoftë njeriu që ka besim te njeriu dhe e bën nga mish i krahun e tij, dhe zemra e të cilit largohet nga Zoti!
Romakeve 3:4*.....Kurrë mos qoftë; përkundrazi, qoftë Perëndia i vërtetë dhe çdo njeri gënjeshtar, siç është shkruar: "'Që ti të shfajësohesh në fjalët e tua dhe të ngadhënjesh kur të gjykohesh''.

Nejm 52:33-34*.....33 A mo ata thonë: "Ai (Muhammedi) e trilloi!" Jo, por ata nuk besojnë. 34 Pra, ata janë drejt, le ta sjellin një ligjërim si ai.

Shënim: Në Islam, mbledhësit e Hadithit më të besueshem dhe më shpesh të përdorur, përfshijnë Ibn Ishaq (vd. 768), Ebu Davud (vd. 775), Ibn Hisham (vd. 833), Muhammad al-Bukhari (vd. 870), Sahih Muslim (vd.875), Ibn Maje (vd. 886), al-Tirmidhi (vd. 892), Ebu Jafer Taberi (vd. 923). Asnjë nga këta burrat jetuan veç shumë vite pas jetës së Muhamedit (570-632).

146.

A pret Perëndia që besimtarët, në mënyrë aktive, ta adhurojnë sëbashku dhe të shpallin besimin e tyre?

Bibla Po / Po Kurani

Mateu 28:19.....Shkonë, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë,
2 Korintasve 5:20*.....Ne, pra, bëhemi lajmëtarë për Krishtin, sikurse Perëndia të këshillonte nëpërmjet nesh; dhe ne ju këshillojmë juve për hir të Krishtit: Paqtohuni me Perëndinë!

1 Pjetri 3:15*.....dhe jini gjithnjë gati për t'u përgjigjur në mbrojtjen tuaj kujtdo që ju kërkon shpjegime për shpresën që është në ju, por me butësi e me druajtje,

Nahl 16:125*.....Ti (Muhammed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira.

147.

A dëshorin Perëndia që besimtarët të ndahen në sekte, denominacione dhe grupe me përçarje?

Bibla Jo / Jo Kurani

1 Korintasve 1:10-13*.....10 Tani vëllezër, ju bëj thirrje në emër të Zotit tonë Jezu Krishtit të flisni që të gjithë të njëjtën gjë dhe të mos keni ndasi midis jush, por të jeni plotësisht të bashkuar, duke pasur një mendje dhe një vullnet.

1 Korintasve 3:3-4*.....3 në fakt sepse midis jush ka smirë, grindje e përçarje a nuk jeni të mishit dhe a nuk ecni sipas mënyrës së njerëzve? 4 Sepse, kur dikush thotë: "Unë jam i Palit'", dhe një tjetër: "Unë jam i Apolit'", a nuk jeni ju të mishit?

Al-i İmran 3:103*.....Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur'anin) e All-llahut, e mos u përçani!

En'am 6:159*.....Vërtet at që e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në grupe, ti (Muhammed) nuk ke kurfarë përgjegjësie.

148.

A ka vargje në Librat e Shenjtë që i nxitin njerëzit të jenë të gëzuar dhe të lumtur këtu në këtë jetë në tokë?

Bibla Po / Jo Kurani

Psalmet 5:11*....Por le të gëzohen tërë ata që kanë strehë te ti, le të nxjerrin klithma gëzimi përjetë,

Romans 14:17.....sepse mbretëria e Perëndisë nuk është të ngrënë dhe të pirët, por drejtësia, paqja dhe gëzimi në Frymën e Shenjtë.

Filipianeve 4:4.....Gëzohuni gjithnjë në Zotin; po jua them përsëri: Gëzohuni!

Zuhruf 43:70*.....Hyni në Xhennete, ju she gratë tuaja, të gëzuar!

İnsan 76:11*.....Po All-llahu i ruajti ata prej sherrit të asaj dite dhe u dhuroi shkëlqim në fytyra e gëzim të madh.

Shënim: Të vetmit vargje në Kura'n që tregojnë për gëzim, kanë lidhje me jetën pas të tanishmit.

149.*

A ka shembuj në Librat e Shenjtë ku Perëndia u sjell njerëzve shërim fizik?

Bibla Po / Jo Kurani

Eksodi 15:26.....unë nuk do të jap asnjë nga ato sëmundje që u kam dhënë Egjiptasve, sepse unë jam Zoti që të shëron".

Psalmet 103:2-3.....2 Beko, shpirti im, Zotin dhe mos harro asnjë nga të mirat që ka bërë. 3 Ai fal të gjitha paudhësitë e tua dhe shëron të gjitha sëmundjet e tua,

Mateu 4:23*.....Jezusi shkante kudo nëpër Galile, duke mësuar në sinagogat e tyre, duke predikuar ungjillin e mbretërisë dhe duke shëruar çdo sëmundje dhe çdo lëngatë në popull.

1 Korintasve 12:28 & 30.....28 Dhe Perëndia i vuri disa në kishë... pastaj vepra të fuqishme; pastaj dhuntitë e shërimit, 30 A kanë të gjithë dhuntinë e veprave të fuqishme?

Shënim: Gjendën 26 shërime të shënuara bërë nga Jezusi vetëm në Dhjatën e Re, por asnjëherë në Kura'n Perëndia i jep shërim fizik njerëzve gjatë jetës së Muhamedit.

150.*

A ka vargje ku Perëndia i nxit besimtarët të përdorin muzikë, vallëzim dhe këndim gjatë adhurimit?

Bibla Po / Jo Kurani

Psalmet 100:1-2.....2 I shërbeni Zotit me gaz, ejani para tij me këngë gëzimi.

Efesianeve 5:18-19*.....18 por mbushuni me Frymë, 19 duke i folur njeri tjetrit me psalme, himne dhe këngë frymërore, duke kënduar dhe duke lavdëruar Zotin me zemrën tuaj,

Kolosianeve 3:16.....mësoni dhe këshilloni njeri tjetrin me psalme, himne dhe këngë frymërore, duke kënduar Zotit me hir në zemrat tuaja!

Shënim: Në Bibël gjendën mbi 450 vargje që inkurajojnë muziken, të kërcyerit dhe të kënduarit, por nuk ka vargje të tilla në Kura'n.

151.*

Sipas qëllimit të zbuluar të Perëndisë, a është e drejtë që një burrë të ketë më shumë se një grua në të njëjtën kohë?

Bibla Jo / Po Kurani

Ligji i Përtërirë 17:17*.....Nuk duhet të ketë një numër të madh grash, me qëllim që zemra e tij të mos shturet;
1 Korintasve 7:2*.....Por, për shkak të kurvërimit, le të ketë secili gruan e vet dhe secila grua burrin e vet.

Nisa 4:3-5 & 24*....4 atëherë martohuni me ato gra që ju pëlqejnë; me dy, me tri e me katra.

Ahzab 33:21, 32-33, 38 & 50*.....21 Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e All-llahut, 32 O gratë e Pejgamberit, 38 Pejgamberit nuk i përket kurrnjë qortim për atë që All-llahu e ngarkoi me të. 38 O ti Pejgamber, Ne të kemi lejuar gratë, të cilave u ke dhënë shpërblimin e kurorës,

152.

A do të ishte e mundur që një burrë t'i trajtonte gratë njësoj po të kishte më shumë se një grua në të njëjtën kohë?

Bibla Jo / Jo Kurani

Ligji i Përtërirë 21:15.....Në goftë se një burrë ka dy gra, dhe njerën e dashuron dhe tjetrën e urren,
Nehemia 13:26-27*.....26 Dhe thashë: "A nuk mëkatoit, vallë, Salomoni, mbret i Izraelit, për këto gjëra? por gratë e huaja e bënë edhe atë të mëkatojë. 27 A duhet, pra, të dëgjojmë për ju se kryeni këtë të keqe të madhe, se mëkatoni kundër Perëndisë tonë, duke u martuar me gra të huaja?".

Nisa 4:3*.....E nëse i frikoheni padrejtësisë (ndaj tyre), atëherë vetëm me një, ose (martohuni) me ato që i keni nën pushtetin tuaj (robëreshat). Ky (përkufizim) është më afër që të mos gaboni.

Nisa 4:129*....Ju kurrësi nuk do të mund ta mbani drejtësinë mes grave edhe nëse përpigëni, pra mos anoni plotësisht nga ndonjëra e të lini tjetrën si të varur.

153.

A janë të lejuara martesat e përkohshme ose të ndërmjetme? (Mut'a)

Bibla Jo / Po Kurani

Malachi 2:16*.....Sepse Zoti, Perëndia i Izraelit, thotë se ai e urren divorcin dhe atë që e mbulon me dhunë rroben e vet", thotë Zoti i ushtrive. Tregoni, pra, kujdes për frymën tuaj dhe mos u sillni me pabesi.

1 Korintasve 7:10-13*.....10 që gruaja të mos ndahet nga burri, 11 Dhe burri të mos e lërë gruan.

Nisa 4:24.....(Nuk u lejohej të martoheni) Edhe me gra të martuara (që kanë burrat e nuk janë të lëshuara), përveç atyre që i keni futur në pushtetin tuaj (robëreshat e luftrës). (Ky është) obligim mbi ju nga All-llahu. U janë lejuar... E nuk ka pengesë për ju, pas përcaktimit (te niqahut), në atë që ju pëlqeni mes vete.

Maide 5:87.....O ju që besuat! Mos i ndaloni (mos i bëni haram) të mirat që për ju i lejoi (i bëri hallall)

154.

Në Librat e Shenjtë, a konsiderohen gratë si një objekt seksi, një mall apo një pronë të burrave të tyre?

Bibla Jo / Po Kurani

1 Pjetri 3:7*.....Ju burra, gjithashtu, jetoni me gratë tuaja me urtësi, duke e çmuar gruan si një enë më delikate dhe e nderoni sepse janë bashkëtrashëgimtare me ju të hirit të jetës, që të mos pengohen lutjet tuaja.

Efesianeve 5:25*.....Ju, burra, t'i doni gratë tuaja, sikurse edhe Krishti ka dashur kishën dhe e ka dhënë veten e vet për të,

Baqara 2:223*.....Gratë tuaja janë vendmbjellje e juaj, afrohuni vendmbjelljes suaj si të dëshironi,
Al-i Imran 3:14*.....U është zbukuruar njerëzve dashuria ndaj të këndjeve prej grave, djemve, pasurisë së grumbulluar nga ari e argjendi, ndaj kuajve të stolisur, bagëtisë e bujqësisë.

155.*

A është e pranueshme për një njeri për të blerë apo kapjen skllevër dhe të ketë marrëdhënie seksuale me ta?

Bibla Jo / Po Kurani

1 Korintasve 7:23.....Ju jeni blerë me një çmim, mos u bëni skllevër të njerëzve.

1 Selanikasve 4:3-7*.....3 Sepse ky është vullneti i Perëndisë: shenjtërimi juaj; të hiqni dorë nga kurvëria; 4 që secili prej jush të dijë ta mbajë enën e vet në shenjtëri dhe me nder,

Nisa 4:24.....(Nuk u lejohet të martoheni) Edhe me gra të martuara (që kanë burrat e nuk janë të lëshuara), përveç atyre që i keni futur në pushtetin tuaj (robëreshat e luftës).

Mü'minun 23:5-6*.....5 dhe ata të cilët e ruajnë nderin e vet (sa i përket jetës intime), 6 me përjashtim ndaj grave të veta (me kurorë) dhe ndaj atyre (robëreshave) që i kanë në pronësinë e vet, për të cilat nuk janë të qortuara,

Ma'arij 70:22 & 29-30*.....22 atyre që falen 29 Edhe ata që janë ruajtur prej punëve të ndyra (amorale). 30 Me përjashtim ndaj grave të veta dhe ndaj robëreshave që i kanë në posedim, ata nuk qortohen për to.

156.*

A kërkohet që gratë të mbajnë vel (perçe) jashtë shtëpisë?

Bibla Jo / Po Kurani

1 Korintasve 11:15*.....Por në qoftë se gruaja i ka flokët të gjata, kjo është lavdi për të, sepse flokët i janë dhënë asaj për mbulesë.

Galatasve 5:1.....Qëndroni, pra, të patundur në lirinë, me të cilën Krishti na liroi, dhe mos hyni përsëri nën zgjedhën e skllavërisë.

Kolosianeve 2:20.....përse u nënshtroheni disa rregullave

Ahzab 33:59*.....O ti Pejgamber, thuaju grave tua, bijave tua dhe grave të besimtarëve le të vëjnë shamitë (mbulojë) e veta mbi trupin e tyre, pse ky është më afër që ato të njihen (se nuk janë rrugaçe) e të mos ofendohen.

157.

A janë të drejtat e grave të njëjta me ato të burrave?

Bibla Po / Jo Kurani

Ligji i Përtërirë 16:19.....Nuk do ta prishësh drejtësinë, nuk do të tregohesh i anshëm dhe **1 i Kornikave 19:7**.....Tregoni kujdes për atë që bëni, sepse tek Zoti, Perëndia ynë, nuk ka asnjë padrejtësi, as anësi, as pranim dhuratash.

Romakeve 2:11.....Sepse te Perëndia nuk ka anësi.

Galatasve 3:28.....Nuk ka as Jude, as Grek, nuk ka as skllav as të lirë, nuk ka as mashkull as femër, sepse të gjithë jeni një në Jezu Krishtin.

Jakobi 2:9.....por në qoftë se bëni preferenca personale, ju kryeni mëkat dhe dënoheni nga ligji si shkelës.

Bakara 2:228 & 282*.....228 Edhe atyre (grave) u takon e drejta sikurse edhe përgjegjësia në bashkëshortësi, e burrave u takon një përparësi ndaj tyre. 282 Kërkoni të dëshmojnë dy dëshmitarë burra nga mesi juaj, e në qoftë se nuk janë dy burra, atëherë një burr e dy gra,

Nisa 4:3, 11 & 176*.....3 atëherë martohuni me ato gra që ju pëlqejnë; me dy, me tri e me katra. 11 All-llahu ju urdhëron për (çështen e trashigimit) fëmijët tuaj: për mashkullin hise sa për dy femra;

158.*

A lejohet ndonjëherë që një burrë të rrahë gruan e tij?

Bibla Jo / Po Kurani

Efesianeve 5:25-29*.....28 Kështu burrat duhet t'i duan gratë e veta porsi trupat e tyre;

Kolosianeve 3:19.....Ju bashkëshortë, duaini bashkëshortet tuaja dhe mos u bëni të ashpër ndaj tyre.

1 Pjetri 3:7*.....Ju burra, gjithashtu, jetoni me gratë tuaja me urtësi, duke e çmuar gruan si një enë më delikate dhe e nderoni sepse janë bashkëtrashëgimtare me ju të hirit të jetës, që të mos pengohen lutjet tuaja.

Nisa 4:34*.....E ato që keni dro kryelartësisë së tyre, këshilloni, madje largohuni nga shtrati (e më në fund), edhe rrahni (lahtë, nëse nuk ndikojnë këshillat as largimi), e nëse ju respektojnë, atëherë mos u sillni keq ndaj tyre.

159.*

A lejohet ndonjëherë që një i krishterë ose musliman të martohet me dikë që ka një besim tjetër?

Bibla Jo / Po Kurani

Ligji i Përtërirë 7:3-4.....3 Nuk do të lidhësh martesë me ta. Nuk do t'u japësh bijat e tua bijve të tyre dhe nuk do të marrësh bijat e tyre për bijtë e tu,

1 Korintasve 7:28 & 39*.....39 ajo është e lirë të martohet me cilin të dojë, veçse kjo punë të bëhet në Zotin.

2 Korintasve 6:14 & 17*.....14 Mos hyni në një zgjedhë bashkë me të pabesët,

Maide 5:5*.....Sot u lejuan për ju ushqimet e mira, edhe ushqimet (të therrurat) e ithtarëve të librit janë të lejuara (hallall) për ju, edhe ushqimet (të therrurat) tuaja janë të lejuara për ta (u janë lejuar). Gratë e ndershme besimtare, dhe (gra) të ndershme nga ata të cilëve u është dhënë libri para jush, kur atyre u jepni pjesën e caktuar të kurorës, por duke pasur për qëllim martesën, jo imoralitetin dhe jo si dashnore ilegale.

A është shkelja e kurorës arsyeja e vetme e lejuar për divorc?

Bibla Jo / Po Kurani

Mateu 5:32.....Por unë po ju them: Kushdo që e përzë gruan e tij, me përjashtim të rastit të kurvërisë, e bën atë të shkelë kurorën; dhe kushdo që martohet me një grua të ndarë, shkel kurorën.

Mateu 19:3-9*.....Por unë ju them se kushdo që e lëshon gruan e vet, përveç rastit të kurvërisë, dhe martohet me një tjetër, shkel kurorën; edhe ai që martohet me gruan e ndarë, shkel kurorën''.

Bakara 2:231*.....E kur t'i keni lëshuar gratë... e mos i mbani sa për t'i dëmtuar, e të bëheni të padrejtë. vetveten.

Tahrim 66:5*.....Nëse ai u ka lëshuar juve, është detyrë e Zotit të tij t'i bëjë zëvendsim me gra edhe më të mira se ju... që kanë qenë të martuara ose virgjiresha.

161.

A është synimi i të krishterit të veprorë si Krishti dhe synimi i muslimanit të veprorë si Muhamedi?

Bibla Po / Po Kurani

Mateu 10:25.....25 I mjafton dishepullit të bëhet si mësuesi i tij dhe shërbëtorit të bëhet si zotëria e tij.

Luka 6:40.....Dishepulli nuk ia kalon mësuesit të vet, madje çdo dishepull që ka mësuar do të jetë si mësuesi i vet.

Gjoni 14:15 & 23-24*.....15 "Nëse më doni, zbatoni urdhërimet e mia. 23 Jezusi u përgjigj dhe i tha: "Nëse ndokush më do, do ta zbatojë fjalën time; 24 Kush nuk më do, nuk i zbaton fjalët e mia;

Al-i İmran 3:31*.....Thuaj: Nëse e doni All-llahun, atëherë ejani pas meje që All-llahu të ju dojë, t'ju falë mëkatet tuaja,

Nisa 4:80*....Kush i bindet Pejgamberit, ai i është bindur All-llahut,

Ahzab 33:21*.....Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e All-llahut,

Zukhruf 43:63.....Isai tha... frikë All-llahun dhe më respektoni mua!

Armiqtë dhe Lufta

162.

Në Librat e Shenjtë, a ka një temë mbizotëruese që një besim të nënshtrojë me forcë të gjitha fetë e tjera?

Bibla Jo / Po Kurani

Luka 17:20-21*.....20 "Mbretëria e Perëndisë nuk vjen në mënyrë të dukshme; 21 dhe as nuk do të mund të thuhet: "Ja, këtu", ose: "Ja, atje"; sepse ja, mbretëria e Perëndisë është përbrenda jush".

Romakeve 14:17 & 22*.....22 A ke besim ti? Mbaje besimin për veten tënde përpara Perëndisë;

Tevbe 9:33*.....Ai (All-llahu) është që e dërgoi të dërgarin e Tij me udhëzim të drejtë e fe të vërtetë, e për ta bërë që të dominojë mbi të gjitha fetë, edhe pse e urrejtën idhujtarët.

163.*

Në çështjet fetare, a duhet miratuar ndonjëherë përdorimi i dhunës dhe detyrimit?

Bibla Jo / Jo Kurani

2 Timoteut 2:24-25*.....24 Sepse shërbëtori i Zotit nuk duhet të zihet, por të jetë i butë me të gjithë, i aftë për të mësuar njerëzit dhe i durueshëm, 25 duke i mësuar me butësi kundërshtarët,

Bakara 2:256*.....Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota.

Al-i İmran 3:20.....Nëse janë nënshtruar, atëherë janë përudhur e nëse refuzojnë, vërtet ti ke (për obligim vetëm) kumunikimin;

Gasiye 88:21-22.....21 E ti pra, këshillo, se je vetëm përkujtues, 22 Ti ndaj tyre nuk je mbizotërues!

164.*

A i nxit Perëndia besimtarët sot të luftojnë kundër njerëzve të besimeve të tjera derisa besimi i tyre të triumfojë? (Lufta e Shenjtë / Xhihad)

Bibla Jo / Po Kurani

Romakeve 12:17-19*.....17 Mos ia ktheni kurrkujt të keqen me të keqe, 18 Po të jetë e mundur dhe aq sa varet prej jush, jetoni në paqe me gjithë njerëzit. 19 Mos u hakmerrni për veten tuaj, o të dashur, por i jepni vend zemërimit të Perëndisë, sepse është shkruar: "'Mua më përket hakmarrja, unë kam për të shpague, thotë Zoti''.

Hebrenjte 12:14....Kërkoni paqe me të gjithë dhe shenjtërim, pa të cilin askush nuk ka për të parë Perëndinë,

Bakara 2:190-193 & 216*.....190 Dhe luftoni në rrugën e All-llahut 191 Dhe luftoni ata kudo që t'i zini... Fitneja është më e rëndë se vrasja. 193 Vritni ata derisa të zhduket fitneja dhe të aplikohet feja vetëm për All-llahun.

Tevbe 9:29*.....Luftoni ata që nuk besojnë All-llahun e as botën tjetër, nuk e konsiderojnë të ndaluar (haram) atë që e ndaloi All-llahu dhe i dërguari i Tij, nuk besojnë fenë e vërtetë, prej atyre të cilëve u është dhënë libri, derisa ta japin xhizjen në dorë e duke qenë të mposhtur.

165.

Nëse një njeri lë fenë e familjes së tij ose vendos të kthejë fenë, a duhet vrarë ai?

Bibla Jo / Po Kurani

Hebrenjte 3:12-13*.....12 Kini kujdes, vëllezër, se mos ndonjë nga ju ka zemër të ligë, mosbesimi, që të largohet nga Perëndia i gjallë, 13 por nxitni njeri tjetrin çdo ditë, derisa thuhet: "Sot", që të mos ngurtësohet ndonjë nga ju prej mashtrimit të mëkatit.

Nisa 4:89*.....Mos izininipër miq prej yre deisa ata të shpëngulen (si ju) për hirë të All-llahut, enëse refuzojnë, ataherë kudo që t'i gjeni, kapni dhe mbytni **Shënim:** E thëna në vijim e Muhamedit rreth të larguarve te besimit (apostatet) nga Hadith: Apostulli i Allahut, "Kushdo që e ka ndryshuar fenë e tij Islame, atëherë vrini atë." (Sahih Bukhari: Vol. 9, Libër 84, Nr. 57-58, Krahaso: Vol. 4, Libër 56, Nr. 808)

166.

A rekomandohet ndonjëherë luftë kundër familjes, miqve ose qoftë edhe kundër bashkëbesimtarëve?

Bibla Jo / Po Kurani

1 Korintasve 7:13-24*.....13 Edhe gruaja, që ka një burrë jobesimtar, në qoftë se ai pranon të jetojë bashkë me të, të mos e lërë atë, 14 sepse burri jobesimtar është shenjtëruar me anë të gruas, dhe gruaja jobesimtare është shenjtëruar me anë të burrit, 16 Sepse çfarë di ti, o grua, nëse ke për ta shpëtuar burrin? Ose ç'di ti, o burrë, nëse ke për ta shpëtuar gruan?

Mujadila 58:22*.....Nuk gjen popull që e beson All-llahun dhe ditën e gjykimit, e ta dojë atë që e kundërshton All-llahun dhe të dërguarin e Tij, edhe sikur të jenë ata (kundërshtarët) prindërit e tyre, ose fëmijët e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre.

Taghabun 64:14*.....O ju që besuat, vërtet, disa nga bashkëshortet tuaja dhe nga fëmijët tuaj janë armiq tuaj, andaj kini kujdes ndaj tyre,

167.

A dëshiron Perëndia sot që besimtarët të vrasin njerëz të besimeve të tjera paçka se mund të jetë kundër ndërgjegjës së tyre?

Bibla Jo / Po Kurani

Veprat 24:16*.....Prandaj unë përpigem të kem vazhdimisht një ndërgjegje të paqortueshme përpara Perëndisë dhe përpara njerëzve.

1 Timoteut 1:5*.....Qëllimi i këtij urdhërimit është dashuria, prej një zemre të pastër, prej një ndërgjegjeje të pastër dhe prej një besimi jo të shtirur.

Bakara 2:216*.....Juve u është bërë obligim kitali (xhihadi) , ndonëse ju e urreni atë. Por mund që ju ta urreni një send, e ai është shumë i dobishëm për ju, dhe mund që ju ta doni një send, e ai është dëm për ju. All-llahu di, e ju nuk dini.

